

LLAZO POLO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

BJH-2
P83

Vjerill

që
ngatërroi
derën



TREGJEME
ESKICA
MUMORISTIKE

814-7

P83

LLAZO POLO

NJERIU QË NGATËRROI DERËN

Tregime e skica humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LEFKOJA U KTHYE NË FSHAT

Që kur mbërriti në fshatin e tij, Lefko Azemit i kishte hyrë një mizë brenda në kokë, dhe nga kjo gjë ai u bë një xanxar i madh, nuk të qaste fare në bisedë. Thonë se nga ushtria Lefkoja erdhi si mollë e kuqe, me shpatulla të zgjeruara e krahë të fortë. Azgan djalë. Pesëmbëdhjetë ditë nuk u duk fare në fshat: nga mëngjesi e deri në orët e vona të mbrëmjes ishte nga të fundit që mbyllte xhirot në bulevardin kryesor të qytetit. I mësoi përmendsh të gjitha ndërmarrjet. «Në bëfsha dot vrimë gjëkundi, në hedhsha dot në dorë atë të flamosur fletë të punës, pa di unë si llafosem me ata që më bien në qafë atje në fshat!» Kështu thoshte me vete Lefkoja.

Një ditë prej ditësh na shkon në një nga ndërmarrjet e qytetit. Ky mendim i erdhi në kokë me ndihmën e kujtesës së tij, që e kishte qiçër. Vite të shkuara, një kushuriri i tij i parë nga nëna i kishte lënë shëndetin fshatit me një «dele shterpë». Shterpën ia kishte bërë kurban shefit të kuadrit të ndërmarrjes «K» Abaz Malos. Dinte që edhe Xheli, bashkëfshatar i tij, kishte pesë para muhabet me shef Abazin. Dhe me këto mend në kokë, futur brenda në thes edhe një gjel deti, u duk para zyrove të ndërmarrjes «K». Ishte ditë e martë. Në zyra dritat ishin akoma ndezur. Lefkoja trokiti në zyrën e kuadrit dhe hapi derën. Thesin me gjelin e detit e la rrëzë murit.

— Urdhëroni! — i thirri me mirësjellje burri që kishte zënë vend në karrige. — Si jeni? Uluni!

— Mirë, faleminderit, — i tha Lefkoja. — Po ju si ma keni shëndetin? Mirë, shyqyr?

— Si e keni punën? — e ndërpreu aty për aty shefi i kuadrit.

— Jam Lefko Azemi. Nuk më njihni? Jo? Do të njihemi më vonë. Kreva shërbimin ushtarak dhe dua të sistemohem në ndonjë punë. Thonë që jam djalë i mirë...

— Ç'profesion keni? — ndërhyri sërish nëpunësi i kuadrit.

— Elektricitist, e mësova në ushtri, — tha Lefkoja.

Ndërkohë gjeli i detit kishte dalë jashtë thesit dhe po krekosej në duart e dy kalimtarëve, të cilët e shikonin për majmëri. Arratisja e gjelit e shqetësoi Lefkon. Doli vetëtimthi përjashta dhe pa se kalimtarët po e vendosnin përsëri gjelin në thes. Si u qetësua se gjeli ndodhej në siguri të plotë, Lefkoja hyri përsëri në zyrën e kuadrit.

— Ç'pate kështu? — e pyeti nëpunësi, që nuk e kuptoi shqetësimin e Lefkos.

— Gjeli! Ishte gjeli! Nejse, gjë pa rëndësi, ashtu e ka ai çamarok.

Nëpunësi i kuadrit e pa të udhës të mos hynte në hollësitë e kësaj meseleje që nuk kishte të bënte me të.

— Për elektricitist ne kemi nevojë, — tha shefi si heshiti pak. — Shkoni në lagje dhe merrni fletën e punës. Do të filloni menjëherë.

— Në lagje?... Po unë s'kam lagje. Jam nga fshati, — u përgjigj Lefkoja me gjysmë zëri, duke e parë nëpunësin drejt në sy.

— Nga fshati? Po përse vini këtu atëherë? Pse nuk shkoni në kooperativë?

— Kam qejf të stabilizohem këtej... Kam edhe ca miq këtu, kam Xhelin, — shtoi Lefkoja.

— Mos humb ditët kot, shok. Ty të pret, fshati, bujqësia. Në kooperativë kanë nevojë për ty. Grurin e mbollën të tjerët, po ti do ta hedhësh draprin së bashku me ta.

— Kam edhe gjelin, shoku Abaz! — nuk u tërhoq Lefkoja. — Jam kushuriri i Xhelit. Eh, sa duhemi me të, si vëllezër! Unë i dua edhe shokët e Xhelit, prandaj dhe s'harxhova ndonjë gjë të madhe... Ja vetëm një gjel!

— Gjel për mua! Për kë më merr kështu? Për Abazin? Ja ku po ta them: Abazi është shkarkuar, pikërisht për këto marifete. Dhe tani, nga thembrat majat, shok! Të paska zënë koka myk. Këto marifete nuk të shkojnë tek unë... Të lutem, mos më shqetëso!

Lefkoja nuk e vuri re nga doli, nga dera apo nga dritarja. Frymën e mbajti në xhade. Gjelin e harroi fare. Kur pa të zotin të llahtaritur, gjeli fluturoi nga thesi dhe krahëhapur u sul drejt xhadesë, por nga pakujdesia u fut në rrotat e pasme të një makine, duke i lënë Lefkos shëndetin. Lefkoja u bë helm për herë të dytë. Me thesin bosh, u nis kokëvarur drejt rrugës. Në fshat arriti natën. Megjithatë nuk doli të nesërmen në fushë. Akoma mbante shpresë te Xheli, të cilin e kishte porositur që t'i gjente ndonjë vend në qytet.

Ditët shkonin, Lefkoja rrinte mbyllur në shtëpi. Nja dy të rinj erdhën një pasdarke të bisedonin me të, por ai u fsheh në dollapin e rrobave. Më vonë krisi fletërrufeja në drejtim të tij. Por Lefkoja nuk doli që nuk doli në punë.

Kaluan edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Një mëngjes herët u nis përsëri për në qytet. Nga Xheli nuk i kishte ardhur asnjë lajm. Rrugën e bëri më këmbë. Nuk donte të hipte në urban, për të mos u takuar me ndonjë bashkëfshatar. Si bëri gjysmën e rrugës u ul dhe ndezi një cigare pranë një çezme. Nga rruga e qytetit po vinte një makinë. Mbi kabinë valëvitej një flamur. KarrocERIA ishte mbushur plot me njerëz, brohorisnin dhe këndonin. Shoferi iu

duk fytyrë e njohur. Ishte pikërisht ai që i kishte shtypur gjelin me rrotat e pasme. Edhe shoferi e njohu dhe qeshi. Lart nga karrocERIA dëgjoI disa zëra: «Lefko! Lefko!» Kur ngriti kokën, midis tyre pa edhe Xhelin. U çel i tëri. Pa pyetur as shoferin, u ngjit në karroceri. U përqa-fua me Xhelin, u takua edhe me disa të tjerë që ishin nga fshati i tij, por që banonin prej kohësh në qytet.

— Po mundohesh për mua deri në fshat? — i qeshi Xhelit. — Të faleminderit shumë! Unë vrisja mendjen se ku do të të gjeja.

Kënga vazhdonte të buçiste. Biseda merrej vesh me vështirësi.

— Po hë, fol! — i tha Lefkoja. — Ç'u bëre?

Makina u nis. Kënga krisi edhe më fort. Edhe Xheli këndonte së bashku me ta. Njëri nga bashkëfshatarët iu drejtua Lefkos:

— Ke dalë për të na pritur kështu?

— Zëre si ta zësh, — tha Lefkoja i shkujdesur. Po e besdisnin shumë kënga, zhurma e makinës dhe pyetje të tilla.

— Po hë, more, si u bë? — iu kthye përsëri Xhelit.

— Në aksion, në aksion, po shkojmë vullnetarë! — ia ktheu Xheli.

— E kam fjalën për mua, bëre gjë apo jo? — tha Lefkoja. Por kënga, që sa po vinte dhe bëhej më e zjarhtë, nuk i linte që të merreshin vesh mirë.

«Hej, drej o punë», thoshte Lefkoja me vete. Xheli herë pas here e rrokte për qafe. Pas pak makina ndaloj. Vullnetarët filluan të zbrisnin. Kur u ngrit më këmbë, Lefkoja pa se kishin mbërritur në qendrën e kooperativës së tyre. Sheshi ishte mbushur me kooperativistë. Lefkos sa nuk i ra të fikët. Në krahun e djathtë të sheshit ishte ngritur një podium i rrethuar me flamurë. Disa kooperativistë dhe vullnetarë hipën në podium. Lefkoja mbeti i hutuar



në mes të karrocerisë. Mitingun e hapi kryetari i kooperativës. Ai falenderoi vullnetarët që erdhën për të punuar përgjithmonë në fshat, në fshatin e ri socialist. Pastaj kritikoi edhe disa të rinj, midis tyre edhe Lefkon, që i vidheshin punës e kërkonin të strukeshin në ndonjë cep andej nga qyteti. Pas tij e mori fjalën Xheli. Në emër të vullnetarëve ai shprehu edhe një herë gatishmërinë për të punuar dhe jetuar në fshat. Lefkoja zbriti nga karrocERIA vetëm si u mbyll mitingu. Vullnetarët e vunë në mes. Xheli i hodhi krahun. Të gjithë shkuan në vatrën e kulturës. Gjithë atë pasdreke vallja nuk pushoi. E futën në valle edhe Lefkon.

Të nesërmen me brigadën «Vullnetari» hodhi edhe ai shatin e parë në fshatin e ri socialist, ku çdo ditë po venë të rinj vullnetarë nga qyteti. Sa për gjelin e detit, atë edhe tani e kujton me turp. Thonë se kur një ditë, në mensën e kooperativës i vunë përpara një thellë gjel deti, ai e ktheu në guzhinë duke thënë: «Ju e dini, më vjen ca si liksht nga të pjekurat!» Të gjithë qeshën. Qeshi edhe Xheli, edhe Lefkoja. Ata tani janë bërë shokë të mirë. Të tillë i bëri balta e arave dhe jo miqësia e dikurshme...

XHEVAHIRET E BAHIRIT

Shoferi Bahir Bahiri, me makinën që mbante dy njësha e dy dysha, kishte rënë në hall të madh. I qe shkrepur «të hante» zhavor.

Në fillim ai vuajti ca «për ta përtypur» po pastaj ia mori dorën dhe «hëngri» zhavor aq sa i doli nga hundët. «Hëngri» jo një lopatë e dy, po për lau nja dy makina me gjithë rimorkio.

Oreksi më i madh i vinte kur fillonte të errej. Kjo ishte për të koha më e përshtatshme për ta kthyer makinën e ngarkuar me zhavor drejt e në shtëpitë e privatëve...

Nga që lapsit nuk ia thoshte shumë, e pa të udhës që lekët e rrugës së parë t'ia numëronte kokërr për kokërr e qindarkë për qindarkë vetë Shumani, domethënë brigadier personal i Bahirit. E kështu, që prej asaj dite, Bahiri, me ndihmën e brigadierit, i mësoi hesapet mirë. Sa javë që iknin, aq myshterinj grumbullonte dhe aq më shumë i shtohesh oreksi (se thonë oreksi vjen duke ngrënë).

Po një ditë, pa qenë i sëmurë, oreksi iu pre. Këshilli popullor i fshatit dhe disa kooperativistë, në një mbledhje të zgjeruar, i thirrën «myshterinjtë» në këtë «sipërmarrje dhe bashkë me ta thirrën edhe Bahirin. Shoferi po e shihte rrezikun dhe menjëherë kërkoi ndihmën e brigadierit, domethënë të Shumanit. Duhej kapërcyer lumi me not të stilit «bretkosë». Shumani u tregua menjëherë i gatshëm.

— Mos e prish gjakun — i tha. — Në të tilla raste duhet mbajtur gjakftohtësia. Po Bahirit, që nuk i kishte mbetur pikë gjaku, nuk i durohej.

— Po duro, more i paduruar! — mundohej ta qetëson-te Shumani. Përse jam unë?

Dhe Shumani nisi të vrasë mendjen. Për të justifikuar disa nga ngarkesat me zhavor që u ishin shitur privatëve, mund të sajoheshin dokumente. Për këtë qëllim, këta të dy dhe një mik i tyre nga «sipërmarrësit» i hipën makinës dhe zbritën drejt e në zyrat e llogarisë së sektorit të parë të kooperativës, meqë shefi i llogarisë, sipas tyre, ishte njeri «i butë». Nga shefi kërkohej një gjë e vogël: të lëshonte nja dy firma, me anën e të cilave të vërtetohej se zhavori, që kishte shitur Bahiri tek myshterinjtë e tij e që shefi i llogarisë s'i kishte parë as në ëndërr, i kishte blerë sektori «për nevojat e kooperativës». Kështu shtegu mbyllej dhe e mira me të mirë do të lahej.

Ata u munduan ta mbulonin këtë punë, mirëpo jorgani që psonisën ishte shumë i shkurtër. . . Ashtu si kooperativistët edhe shefi i llogarisë, ua zbuloi këmbët të gjithëve. «Xhevahirët» që u kurdisën s'e mbuluan dot Bahirin. Çështja mori dhenë dhe arriti gjer në. . . dyert e gjyqit. E atje ndodhi ajo që duhej të ndodhte. Zhavori u ra në kokë Bahirit dhe ca të tjerëve, që me «xhevahaire» u munduan të zgjasnin jorganin e tij të shkurtër.

SADIKU NGATËRROI DERËN...

Ka njëzet e ca ditë që shtatori i vitit që jemi na ka lënë shëndetin. Tetori ecën serbes-serbes në ditët e fundit që i kanë mbetur. Edhe Sadik Adashit nuk i mungonte serioziteti që të ikte dy orë nga puna. Ta themi midis nesh, mjeshtër sporti nuk ishte Sadiku, që t'i takonte një orar i tillë, as edhe ndonjë sportist i kategorisë së parë (duke përjashtuar bilardon...). Të ishte në ndonjë grup të invaliditetit nuk do t'ia shkelte biçikletës me 40 në orë. Por që Sadiku punonte gjashtë orë në ditë, ky është një fakt që nuk e luan as topi. Sadiku e hiqte veten si shkollar. Aty nga fundi i gushtit Sadiku ishte nga të parët që vrapoi për të shënuar emrin në regjistrin e degës mekanike. Ishte i treti vit që përsëriste po këtë avaz dhe që bënte në vend numro.

Pandora, që ishte emëruar rishtas përgjegjëse e zyrës së kuadrit në ndërmarrje, një ditë, në krye të disa punonjësve të tjerë, mori rrugën e shkollës. Shkoi në ndërtesën e re, inaugurimi i së cilës u bë në fillim të vitit të ri shkollor, e jo në të vjetrën ku ishte regjistruar Sadik Adashi. Në të vjetrën fani ishte «Filjalja».

Sadiku e kishte nuhatur që më parë se kontrolli punëtor do të vinte në shkollë. Prandaj bleu një fletore, një laps, hoqi dhe një brisk shpejt te berberi i lagjes dhe pastaj mori udhën për në shkollën ku ishte regjistruar.



Kishin kaluar ditë që atëherë kur kishte filluar viti arsimor. Tani ishte më të dalë të tetorit. Si arriti në kryqëzimin e rrugëve, Sadiku ia shkeli me vrap, ngaqë dëgjoi zilen. Por kur u afrua, u hutua, ngaqë e kuptoi se tingëllinte zilja e kalit të komunales të tërhiqte karrocën e vajgurit. . . Këtë Sadiku e mori për zile të shkollës! Megjithatë edhe zilja e shkollës kishte rënë.

Të gjithë ishin futur nëpër klasa. Sadiku, i habitur, ka tonte sa nga njëra derë në tjetrën dhe mendohej të lexonte diku «Klasa I C-dega mekanike» mirëpo nuk dukej gjë. . . Atë çast vuri re pastruesen e shkollës.

— Cilat klasa bëjnë mësim këtu? — pyeti Sadiku duke treguar katin e parë.

— Këtu është histori — gjeografia — u përgjigj pastruesja.

— Po mekanikja?

— Është në njëra e dytë.

Sadiku me të shpejtë u ngjit lart, trokiti. Dera u hap.

— Me leje? Ka mundësi të hyj?

Pedagogu që shpjegonte termodinamikë e shikoi me habi. Me sa dukej edhe Sadikun e mori për anëtar të kontrollit punëtor. Kjo e bindi kur vuri re se edhe shokët e kontrollit në banga diçka po bisedonin me njëri-tjetrin me zë të ulët.

Si u ul aty nga fundi, Sadikut i zuri syri disa fytyra të njohura. Ishin disa teknikë të mesëm të ndërmarjes. Pandorës, që e kuptoi ngatërresën, i erdhi për të qeshur dhe i tha diçka Gentit në vesh. Sadiku u hutua fare. S'po kuptonte asgjë. Shikonte herë pedagogun dhe herë shokët e tij dhe i ngjante se kishte rënë në një planet tjetër. «Ç'bëhet këtu?» mendoi Sadiku. Si kaloi edhe pak, më në fund e kuptoi se kishte hyrë në tjetër derë. Nuk i durohej sa të mbaronte leksioni.

Zilja ra. Pandora, shokët e kontrollit punëtor, pedago-

gu dhe teknikët e ndërmarrjes, që vazhdonin «Filiale» në këtë kurs qëndruan në klasë.

Sadiku donte të shkiste midis turmës, por nuk mundi, se derën e mbylli një nga shokët e kontrollit punëtor.

Pandora, pasi kontrolloi regjistrin së bashku me pedagogun, u gëzua kur e pa të pastër kolonën e mungesave të punonjësve të ndërmarrjes së saj. Pedagogu foli me respekt për ta. Pastaj ajo desh t'i kthehej Sadikut, por më parë u hodh Genti:

— Suksese Sadik! — i tha me qesëndi.

— Për ç'suksese është fjala? — ndërhyri pedagogu duke qeshur.

— Ka ngjitur shtatë kate brenda këtyre dy muajve! — tha Pandora.

— Ka marrë shtëpi të re kështu? Hajde, të rrish gëzuar! — i tha pedagogu. — Do këmbë të ngjitesh, se është ca lart, por s'ka gjë, i ri je.

— Këmbë dhe kokë — ndërhyri Genti.

— Ç'hyn koka për të ngjitur katet? — pyeti pedagogu.

— Hyn, hyn, — tha Pandora. — Pa kokë mbetesh gjithmonë në katin e parë. Ndodh që të ngatërrosh edhe derën, siç i ndodhi Sadikut.

Ndërkohë Sadikut surrati i ishte bërë flakë nga turpi.

— A, a, ju kuptova! E keni fjalën për vonesën.

— Jo — tha Genti — nuk është fjala për vonesë, po për ngatërresë. Nga viti i parë teknike, që nuk vinte fare, erdhi e u fut këtu në kursin e katërt të «Filiales».

Pedagogu, që e kuptoi se si ishte puna, shikonte Sadikun me habi.

Të them të drejtën s'e kishim parë asnjëherë Sadikun ashtu kokulur surratkuqur. Ishte me të vërtetë një shenjë komike, që Sadiku e luajti ngaqë s'dinte ku binte shkolla dhe dera e klasës së tij...

Të nesërmen Sadiku shkoi drejt e në zyrën e llogarisë

dhe kërkoi që t'i mbaheshin lekët për gjithë ditët që kishte ikur dy orë para nga puna dhe që kishte munguar në shkollë. Si doli nga llogaria, shkoi në librari dhe bleu librat. Të mërkurën mësoi edhe rrugën për në shkollë. Atë ditë shkoi një orë para se të fillonte mësimi. Nuk i durohej sa të binte zilja. . . Një herë u mat t'i binte vetë, aq fort sa të ngopej me të. Kishte shumë deficite në dëgjimin e zileve. . . (me përjashtim të ziles së biçikletës, që e dëgjonte çdo pasdite). Vendosi t'i drejtohej pastrueses së shkollës.

— Bjeri ziles! — i tha asaj.

Pastruesja qeshi. Ajo e kuptoi se Sadiku nuk i dinte mirë rregullat e shkollës.

— Edhe zilja ka orar këtu — i tha ajo.

Pasi ndenji edhe ca në oborrin e shkollës, sa dëgjoi zilen e parë, Sadiku hyri drejt e në klasë. Shokët nuk qeshën.

Tani Sadiku ka filluar të ambientohet edhe me zilen e shkollës.

KËTO ASKUSH S'I HONEPS

Roberti, ose siç e thërresin më shkurt Berti, jeton në mes të lokalitetit. Thonë se ka ngrënë plot një çerek nga ky shekull dhe se në gjendjen civile rezulton i regjistruar në kolonën «burrë i martuar».

«Lodrat» e Robertit nuk kanë të sosur, pa përmendur këtu ato të feminisë, që i ngelen në kurriz moshës, as ato që fillojnë nga dita që hyri në «Mapo» ku bleu makinën «Dajti» për të prerë qimet e faqes. Ne do të komentojmë disa lloje «lodrash» (siç i quan vetë Berti) që i takojnë periudhës më të re në . . .

Kur punoi në oficinë u muar me shumë lloj «lodrash». Në dy gara gati u shpall kampion, për ardhjen çdo ditë një çerek ore vonë në punë dhe për moszbatimin e urdhrave të përgjegjësit. Për këto merita kolektivi ku punonte i vuri kapelen sipas kokës. E caktoi në punë më të vështirë, që të riedukohej, të kalitej në punë, në vështirësi. Por Berti, me që «nuk e pa të arsyeshme këtë stërvitje», u tha lamtumirë, veshi kostumin, vuri një limodhetë të shkurtër në qafë dhe me flokët cullufe-cullufe filloi varavingo poshtë e lart. Duhet ta dini se Berti është esnaf. Kur vinte dita donte të hidhte firmë në bordero. Helbete, kështu e ka taktikën e tij. Kalimi për stërvitje në një vend pune tjetër ishte padrejtësi dhe padrejtësi të tilla zakonisht paguhen me firmë në bordero. Kështu mendonte Berti.



BIBI • ERA B CHTEIT
WITROKASTER
INV. ~~20652~~

20652

Si e pa që nuk i doli gjë nga ekonomia, vendosi t'i turret mjekësisë. Bëri si bëri, e hodhi në dorë një raport për punë të lehtë. (Siç duket ia ka dhënë rekomandimin ndonjë mjek që edhe vetë është ca i lehtë...).

Filloi punën si axhustator në një brigadë tjetër, por edhe këtu, si i sëmurë që ishte, bëri paraqitjen e tha:

— Unë, pavarësisht se peshoj 59 kile e 700 gram, jam «ursus» Ta dini mirë: në qoftë se Anteut ia dha fuqinë Toka, për mua e pa të arsyeshme e ma dha natyra. Prandaj grushti im i rëndë, që ruan çdo proporcion me trupin, për herë të parë do të bjerë në kokën e brigadierit, po qe se ai... — Dhe thonë se i është turrur dy herë me sy të mbyllur, duke tundur vetëm kokën, që nuk i peshon shumë...

Një ditë në një mbledhje dëgjoi të bëhej fjalë për kursimet. Specialistët, mekanikët, teknikët, inxhinierët u zotuan të kursejnë e të bëjnë edhe shpikje. Berti, duke parë se vetë nuk bënte dot gjë në këtë fushë, vendosi të bëjë një lodër tjetër. Sajoi një palë llastiqe me bigëlaçe prej thane dhe aty nga mesi i natës, në vend që të punonte në turnin e dytë, vinte në shinjestër xhamat. Aty ndaj të gdhirë, kur pa se rregullorja e sigurimit teknik e vendosur në xham jetonte, vendosi ta ekzekutojë.

Por që atë ditë edhe ky kolektiv e nxori Robertin nga dritarja që i theu xhamin. Është caktuar të punojë në fronte të tjera pune, në fermë, por ai mundohet të shpëtojë, se është mësuar të bredhë zyrë më zyrë! Herëherës u drejtohet prapë mjekëve, por ç'e do «mushka e harroi valarenë». «Lodrat» e tij askush s'i honeps. Ai i mati me pëllëmbë rrugët e lokalitetit. Kërkoj punë të lehtë që të shijë lehtë, po nuk i dhanë. I thanë gatitu dhe ai po qëndron gatitu. Pa një komandë të tillë, Berti mbetet gjithmonë prapa...

NË RRUGË...

Na njoftuan për Agronin, (mekanikun e ndërmarrjes sonë, që ishte me pushime në shtëpinë e punëtorëve se papritur e kishte kapur një krizë e fortë dhe ishte shtruar urgjent në spital. Do të operohej nga apendisiti. Unë, si shok pune, dhe Rrapoja, si kryetar i komitetit profesional, u caktuam t'i bënim një vizitë.

Shkuam në agjencinë e pasagjerëve. Korridori ishte mbushur plot e përplot, tamam sikur po shitej peshk. Nuk kish ku të hidhje kokrrën e mollës. Për radhën e grave as që bëhej fjalë. Pasagjerët kishin zënë pozicione nga më të ndryshmet, disa me fytyrë nga muri, disa me shpinë, ca në profil, disa kishin hipur mbi zverkun e të tjerëve (dyfishonin gjatësinë). Njëri ishte përkulur fare...

— Siç duket paska vendosur t'i presë biletat me këmbë, — më tha Rrapoja.


Pas disa minutash u dëgjua një zë i hollë dhe i fortë nga brenda: «Shokë pasagjerë! Biletat u mbaruan!»

— Ç'është kjo, si ka mundësi? — i thashë Rrapos. — As pesëmbëdhjetë vetë nuk morën bileta!

Ndërkohë një nga pasagjerët, që po e përdorte këmi-shën në vend të peshqirit, doli shumë i acaruar: «E pashë vetë, ore vëlla, i shiti nga brenda; cave ua dha nga sporteli «i privilegjuar». S'ke ç'i bën, i ka miqtë e saj.»

— Që të marrësh biletë këtu, me sa kuptoj unë me këtë rradaken time — tha Rrapoja — duhet të të bien brinjët. Dhe po more duhet të rrish në ndonjë krevat të mbledhësh kockat. Prandaj, o vëlla xhani, prapa kthes-hu, nga thembrat majat!. Nesër ngrihemi që në mëngjes, gjejmë ndonjë kamion e nisemi me freskollëk për tek Agroni.

Kështu bëmë. Në mëngjes dolëm te kthesa. Shkuan nja tre kamiona, vendet i kishin të zëna. Pa mbaruar mirë fjalën, së largu u duk një «Zis». Megjithëse nuk ishte errësirë, dritat i mbante ndezur. Ectë herë shpejt, herë ngadalë. Kishte zaptuar mes për mes xhadenë. Rrapoja doli në anë dhe i nxori dorën. «Zisi» frenoi fort te këmbët e tij. E ndaloi aq afër, sa unë u tremba. Hipëm. Shoferi na u duk tërë humor.



— Ku je, buçko? — më tha kur zëmë vend në kabinë, sikur të qemë miq të vjetër.

Pastaj, me dy gishtrinjtë hapur si çataj, më mbërtheu me ledhatim në faqe, tamam sikur të isha fëmijë kopshti dhe jo burrë me një okë thinja e me tre kalamaj.

«Zisi» u nis. Herë pas here frenonte. Ne tundeshim e përkuleshim sikur të përshëndesnim pemët, që duke-shin e zhdukeshin me shpejtësi njëra pas tjetrës. Papritmas, nga një frenim i fortë, Rrapos iu përplas koka në xham.

Prisja nga çasti në çast që shoferi të na hidhte në ndonjë kanal. Megjithatë më vinte për të qeshur, ca me shoferin, që këndonte një avaz të pakuptueshëm me fjalë gjysma-gjysma, ca me Rrapon, që fërkonte xhungën në ballë. I thashë Rrapos në vesh:

— Ka pirë, bie erë uzo të pushuar.

Rrapoja ngriti supet i çuditur. «E ç'të të them unë?! S'kemi ç'bëjmë tani, vetëm mbahu fort!»

Para nesh u duk një klub. Rrapoja më pëshpëriti:

— Thuaji ta mbajë. Do të zbresim, të shpëtojmë me kaq!

— Mbaje, vëlla — i thashë — deri këtu e patëm punën.

Shoferi më pa, i hapi përsëri gishtërinjtë si çataj dhe më mbërtheu në faqe:

— Mbushë edhe një herë, buçko! — më tha.

Pastaj filloi nga frenat. Jo një, po tri-katër kolpo të forta. Një dorë e mbanim në ballë dhe një prapa kokës. Në kolpon e tretë «Zisi» u drodh. Kishte dalë jashtë asfaltit. U drodhëm edhe ne të dy, tamam sikur të na kishin zënë ethet e gushtit.

Për fat kanal nuk ishte shumë i thellë. Shoferi vazhonte këngën, me po atë avazin e tij. Rrapoja mbante ballin me dorë.

Zbritëm dhe u futëm në klubin ndanë rrugës. Pranë

ekspresit të kafesë qëndronte banakieri. U përçafua me shoferin. Pastaj të dy kthyen nga një dopio. Unë me Rrapon vajtëm dhe premë dy bileta te pika e shitjes për udhëtimin që kishim bërë. Mirëpo kur ia treguam biletat shoferit, ai na shikoi me inat.

— Hë, ec e merri po deshe! — i ankua banakierit. — E sheh si ta punojnë?!

Pasi ktheu nja dy dopio të tjera, shoferi i hipi «Zisit». U nis përsëri me ato kolpot, sikur bënte vrapim me pengesa. Pas pak erdhi një «Skodë». Pasi hipëm në kabinën e saj, shoferi na preu biletat. Fillova muhabetin me të, ndërsa Rrapoja shfletonte një libër që e kishte marrë nga rafti i shoferit.

Pa kaluar as dy-tre kilometra, prapa një kthese të fortë, pamë «Zisin» me të cilin kishim udhëtuar. Gomat i qenë kthyer përpjetë, si i thonë fjalës, shikonin nga die-lli. Makina ishte përplasur pas një plepi, që bërë si ku-ti sardeleje.

Ne zbritëm. Shpejt e shpejt nxorëm shoferin nga kabina. Ishte pa ndjenja. Filluam t'i lëviznim krahët, i bëmë frymëmarrje artificiale. U përmend pak. Era e uzos dhe e konjakut të qelbte. E hipëm në «Skodë». Me shpejtësi e shpëmë në spital. Mjekët na thanë se ishte plagosur rëndë. Aty takuam edhe Agronin. Operacioni i tij kishte dalë me sukses. Atë pasdite ndenjëm bashkë me të. Nga mbrëmja na thanë se shoferi i «Zisit» shpëtoi nga rreziku. U gëzuam shumë. Pastaj vajtëm në agjenci për të prerë biletat e kthimit për të nesërmen. Pa dashur zemra na u drodh, na u kujtua ajo kaladibrancja, që lamë një ditë më parë në agjencinë e qytetit tonë.

Por na doli krejt ndryshe. Biletat i premë sapo vajtëm.

Shkuam të qetë në hotel. Në mëngjes blemë disa pemë dhe takuam përsëri Agronin. Pastaj shkuam edhe te

shoferi i «Zisit». Ai u habit kur na pa. Tani uzoja dhe konjaku i kishin dalë plotësisht. Infermierja, që po i bën-te inxheksionin, i vendosi pemët në komodinë dhe i tha se ne i kishim shpëtuar jetën. Ai na pa drejt në sy. Me siguri që iu kujtua biseda dhe konjaku të klubi ndanë rrugës.

Rrapoja padashur fërkoj xhungën.

Shoferi uli kokën.

TAKTIKA E ZEQOS...

Skuadra «Fusha» e qytetit tonë akoma nuk po lëvizte nga bishti i tabelës së klasifikimit. Ç'është e vërteta, lojtarët turrehin të tërë pas topit. Mirëpo kishte një gjë të keqe: përtonin të ktheheshin në mbrojtje. Dhe hanin gola. Dhe çfarë golash / se! Nga tre më shumë në çdo ndeshje!

Ekipi nuk ishte i përbërë nga çunakër, siç mund të pendehej, jo. Lojtarët ishin të pjekur, nja dy bile ishin burra me një tufë kalamajsh. Të gjithë ata e nderonin trenerin e tyre. Disa thonë se, kur ziheshin ngushtë, betoheshin: «Për kokën e Zeqos»...

Siç mund të merret me mend, ekipi ishte i përbërë prej dymbëdhjetë burrash, me gjithë trenerin. Kishin kohë që luanin së bashku topin e këmbës. Bashkë hanin në mensë, bashkë hanin golat, bashkë po zbrisnin edhe nga kategoria e parë!

E kishin nisur pa qime në faqe futbollin dhe e kishin vazhduar derisa arritën në këtë ditë, me flokët me dy ngjyra. Megjithatë, këmbë nga lodra me top me këmbë, nuk hoqën. Si moshë, mesatarja lëkundej rreth tridhjetë vjet e gjashtë muaj. Skuadra konkuroi për disa vjet rresht në kategorinë e parë. Në vitin e parë nuk ra më poshtë se mesi i tabelës së klasifikimit. Dy vjet radhazi zптоi mes për mes tabelën. Një vit më vonë e vranë ca dasma, (u



martuan nja pesë lojtarë) kështu që ra nën mesin e tabelës. Tani ka nja dy vjet rresht që mbahet me furka.

«Këtë sezon e kemi pisk fare. Jemi në një hall shumë të madh. Sikur një ndeshje të humbasim nga dy që na kanë mbetur, fluturoi kategoria! Dhe po na iku kategoria, na fluturoi trajtimi në mensë. Ec e filloje prapë nga e para, bridh qytet më qytet për të gjetur lojtarë! Është skuadra e të rinjve, por ç'më duhet? I riu si veriu. Po nuk u poq lojtari, të paktën të ketë bërë celebrimin, nuk ia beson dot topin». Ky hall e mundonte Zeqo trainerin. E vriste aq shumë mendjen, sa i qenë shtuar edhe nja tri-katër thingja. Sidoqoftë, më në fund, i dha karar. Do të zhvillonte një bisedë të hapët me të njëmbëdhjetë lojtarët. Dhe vend më të përshtatshëm, për këtë qëllim se pijetorja e sportit nuk kishte ku të gjente.

Me të thënë e me të bërë. Të gjithë lojtarët u mblodhën në klubin sportiv, bashkuan nja dy tavolina, porositen nga një dopio konjak e nga një kafe, pastaj nxorën letër të bardhë e lapsat përpara. Ia filluan punës. Zeqoja, domosdo, e mori fjalën i pari:

— Futbollistë të dashur! Na kanë ngelur edhe dy ndeshje me skuadrat «Bubullima» dhe «Motori». Nga këto të dyja, asnjërës nuk i vlejné dy pikët tona. Pozitat e tyre në tabelën e klasifikimit janë të çimentuara. «Bubullima» e ka siguruar një vend në treshen e parë, «Motori» nuk luan nga mesi i tabelës, edhe sikur nga njëmbëdhjetë të hajë në çdo ndeshje... Prandaj të hidhemi në sulm, shokë! Në asnjë mënyrë nuk duhet të pranojmë të dalim nga kategoria. Se nuk kemi as moshën! Pastaj pse të qeshin dynjaja me ne? Për këtë unë kam menduar një taktikë të hollë dhe tani do t'jua paraqes juve, o vërsnikët e mi. A ju kujtohet? Para ca vjetësh «Bubullima» hyri në gysmëfinalet e kupës. Dhe kush e futi, thoni ju? Ne e futëm, nuk u fut vetë. E futa, unë, treneri juaj, që dikujt

BOLL



nuk iu mbush syrin, personalisht ua fala atyre atë ndeshje. Ja, për këtë konjak, se unë, unë. . .

Zevoja nuk vazhdoi më, sepse u mallëngjye shumë.

— Unë urdhërova Markon që të pesë penalltitë t'i gjuante në stratosferë. Kështu ua dhashë fitoren. Ju e mbani mend gjithashtu trainerin e «Bubullimës» që erdhi dhe, me lot gëzimi, më puthi në të dy faqet. Kështu, shokë! Ndërsa me «Motorin» jemi akoma më miq. Këtë e thonë defterët. Ju e mbani mend mirë kur i doli rakia Maqos, portierit tonë, të nesërmen, pas ndeshjes me «Motorin». Dhe kush i dha të pinte? Unë, shokë. Ja, pra, katër pikë u rregulluan. Tani hajdeni, të dashur, ta kthejmë këtë dopio, për fitoren tonë të ardhshme.

— Gëzuar! Gëzuar! — e pasuan disa nga lojtarët.

Të nesërmen u nisën për ndeshjen me «Bubullimën». Me vete morën edhe tifozin e njohur Vero Kopin, sepse ky e kishte baxhanak portierin e «Bubullimës». Kështu që po të mos u delte gjë pazarllëku me trainerin, atëherë kalaja do të merrej nga brenda. Mirëpo, kur vajtën në stadium, ndodhi çudia. Aty panë mbi 20 futbollistë, të gjithë në moshë të re, të shkathët, energjikë, të veshur me tuta sportive, ngjyrë blu. Zevoja, duke fërkuar sytë, vrapoi drejt tyre. Kur u afrua, u vrenjt në fytyrë. Nuk po shikon-te asnjë nga lojtarët që kishte njohur më parë.

— Çuna! Ku është treneri i «Bubullimës» dhe futbollistët e saj?

— Ne jemi, — u përgjigj një djalosh shpatullgjerë.

Zevoja, i habitur, mblodhi buzët.

— Por jo, mor çuna, jo! Nuk pyeta për skuadrën e pionierëve. E kam fjalën për skuadrën e burrave, të burrave të pjekur, që kanë ndeshje me ne sot, në orën 15, më kuptoni apo jo?

Të kuptuam, të kuptuam, — ndërhyne nja dy futbo-

llestë të tjerë — Ja, ne jemi ata që do të luajmë me ju sot në orën 15.

— Ju do të luani me ne?! Por ju akoma jeni axhaminj, more! Kini pjekuri ju për një skuadër të kategorisë së parë?!

— Ndeshja me ju sot, si dhe ndeshjet e ardhshme, besojmë do të na kalisin — ia priti një nga lojtarët, me një romuz, që i theri Zeqos.

— Po nuk pashë kolegun tim, Trainer Pashon, nuk e besoj unë që ju përfaqësoni «Bubullimën».

— Pashoja nuk është më treneri ynë. Ai tani shtet aranzhata. Trainer kemi këtë shokun. . .

— Ky e ka zëvendësuar Pashon, shokun tim më të ngushtë?

Asnjëherë Zeqoja nuk ishte habitur kaq.

— Po — ia përforcoi djaloshi. — Sivjet ka ardhur, është me shkollë të lartë dhe i specializuar posaçërisht për futboll.

— Gëzohem shumë! Ju paraqitem, treneri i skuadrës «Fushë», Zeqoja. Dhe ta merrni vesh, ish-traineri juaj, Pashoja, mua më ka. . . më ka, si të thuash. . . një. . . një borxh të vjetër. . .

— Mund t'ju ndihmojmë, duke i thënë Pashos që t'jua kthejë, — u përgjigj treneri i ri.

— Sigurisht, sigurisht, patjetër! Edhe me ju do të merremi vesh, shoku trainer. Pashoja, që thoni ju, të dashur, aty e ca vjet të shkuara ishte ngushtë. Bile mund të them: shumë ngushtë. . .

— E kuptova, po pastaj?

Edhe unë me ekipin tim azgan, ja me këta këtu, i dhashë dy pikë të arta.

— Ju lutem, vazhdoni. . .

— Jo, ju lutem unë juve!

— E pse na luteni?

— Të na i ktheni ato dy pikët. Deri më sot unë nuk jua kam kërkuar. Tani i dua, i dua, vëllaçko, se kam lakun në fyt.,.

— Shoku Zeqo! Kjo që kërkoni ju nuk i përket sportit — e ndërpreu ashpër treneri i «Bubullimës».

— Sportit, sportit! Borxh sporti është — vazhdoi Zeqoja.

— Unë dhe shokët e mi nuk njohim borxhe të tilla. Skuadra jonë njeh vetëm luftën e ndershme sportive. Mirupafshim, pasdite, shoku Zeqo!

Trainer Zeqoja ngeli në vend, si i goditur nga rrufeja. Sytë i mbetën nga treneri i ri dhe futbollistët e «Bubullimës» që po largoheshin. Mendja po i vinte vërdallë. Çfarë bubullime! Dy herë i doli në orbitë Pashoja.

Pasdite, së bashku me të njëmbëdhjetë vërsnikët e tij, trainer Zeqoja mori shtatë gola, njëri më i bukur se tjetri, dhe flet udhëtimin për një kategori më poshtë...

KU I SHPIE MUSHKA?

Unë nuk e di se kur e si ka lindur kënga «Hajt t'ia themi njëzë», por di se atë ditë ne e filluam papritur bashkë me Ramon, kontrollorin tonë rrugor, në një cep të maskuar të rrugës automobilistike.

— Hajt t'ia themi një të na bëhen...

— Një, — ma priti Ramoja, — sepse një është edhe ky «Zisi» që po vjen. Është i parkut të qytetit tonë. Kjo makinë vjen bosh nga Tirana në Vlorë. Me sa duket shoferi do të jetë ndodhur bosh kur ka kërkuar fletën boshe. Agjenti do të jetë ndodhur akoma më bosh kur ia ka lëshuar. Vetëm Ramoja nuk u ndodh bosh kur i mori latat dhe ia ktheu patentën bosh...

— Hajt t'ia themi dy, të na bëhen tri, — vazhdova unë.

— Tri të mbeten — më ndërpreu Ramoja — sepse trivendshe është edhe kjo «Skoda» që po vjen.

Brenda në kabinë, pas kontrollit që i bëmë, doli se kishte të tre udhëtarët pa biletë nga një udhëtim prej 150 kilometrash, kështu që, pasi i preu biletat Ramoja, i bëri edhe një kapërcim nga lata e dytë në të tretën.

— Do t'ia themi katër të na bëhen pesë — thashë unë, që e merrja i pari fjalën.

— Pesë gishta i ka dora — tha Ramoja — pesë janë edhe këto makinat, që, megjithëse bie shi dhe kanë mu-

shama, nuk e mbulojnë nitratin po e lënë të shndërrohet në lëng që të plehrojë asfaltin.

Shoferat që i mbuluan karrocëritë me mushama aty për aty, i lanë për kujtim Ramos nga një latë.

Kënga jonë, të dashur shoferë, atë ditë nuk arriti ndonjë numër tjetër rekord, megjithëse ne qëndruam deri në orët e vona të natës. Në fakt atë natë shkuan një numër rekord automjetesh, se ishte kohë fushate në bujqësi, por ishin të përpiktë në dokumente dhe në rregullat e tjera të qarkullimit rrugor. Aty ndaj të kthyer na erdhi një «Gaz» me shpejtësi të madhe. Ramoja dhe unë e bëmë të frenoje në vend. Dhe, me sa mora vesh më vonë, ai shofer u frenua dhe u stopua përfundimisht nga komisioni i skualifikimit për të mos hipur më në ndenjësën e shoferit e për të mos patur fatin të drejtonte timonin e «Gazit 51» si dhe të çdo lloj automjeti tjetër, me benzinë qoftë ose me naftë. U la i lirë të ngasë vetëm... biçikletën!

SADUSHIT I SHTRËNGUAN BURGJITË

Sadushi, llogaritari i kooperativës, kishte një huq. Po të hyje në gojën e tij, kishte aq aftësi sa që fijen e flokut të fëmijës së porsalindur ta bënte sa trungun e rrapit shekullor, ndërsa mizën e dheut ta bënte buall. Po çfarë bualli se, nga ata që tërheqin qerren me gjithë Sadushin lart! Ky huqi i tij, që në fund i shkoi huq, i kishte rrënjët të thella...

Mjaftonte që syri i Sabriut, mikut të tij, që hiqej si qengj e ishte ujk, në një ditë të bukur pranverore të shikonte aty ndanë rrugës të bijën e Taqos me të birin e Naqos që bisedonin çiltër me njëri-tjetrin, se pastaj këtë gjë kishte borxh t'ia thoshte Sadushit e ky, brenda asaj nate, ta përhapte jo në dy-tri shtëpi, por në të gjithë fshatin, bile të sajuar e të ndryshuar sipas qejfit, aq sa e bënte edhe plakun e moçëm, që ka më se 10 vjet që e kanë lënë ata të flamosur veshë, të thoshte:

— More, po ajo çupë e Taqos... po evlati të turpëron së gjalli!..

Sabriu, kur dëgjonte ato që gatuante vetë, fërkonte duart diku i vetëmuar.

Ndodhte dhe ndodh shpesh që ndonjë përgjegjës sektori të shprehë dëshirën për të kaluar nga zyra në prodhim. Sapo e merr vesh, Sabriu i del Sadushit si hije

përpara me një buzëqeshje të shtirur... dhe pastaj Sadushi fillon:

— E patë, e hoqën, e shkarkuan në vend, brenda njëzet e katër orëve e hoqën si përgjegjës se kishte qenë pesë orë e gjysmë ballist, dhe kjo është e vërtetë — thosh-te ai. — E di unë. E kam parë vetë me sytë e mi, me sytë e ballit... Në filan fshat, kishte zënë e po shqyente një pulë shqerake, së bashku me tre ballistë të tjerë (s'ka gjë se përgjegjësi i sektorit në kohën e Ballit ishte vetëm pesë vjeç!) E ç'nuk nxirrte nga zemreku i tij i kurdisur, por i skaduar, ky Sadushi!

— Rukija nuk martohet, se e ka ndaluar doktori; zooteknikun do ta heqin; normisten do ta çojnë në fushë; kryetarin e këshillit popullor të fshatit e kanë me sy të keq; berberin e kanë lajmëruar të shkojë qerrexhi në stalla. Rrapoja do ta lerë gruan me shtatë çiliminj, se është sevdallepsur me komshijen e tezes sime, që i ka vrarë burrin rrufeja në depon e kashtës.

E ç'nuk pillete fantazia e Sadushit!

Mirëpo «vete e vjen qypi në çezmë, por pastaj thyhet», thotë një fjalë e urtë popullore. Një ditë Sadushin e nxorën para gjyqit. Në atë seancë nuk kishte gjyqtarë, se gjyqtarë qenë vetë kooperativistët, vetë kolektivi, lagja dhe fshati ku banonte Sadushi.

— Dritës i kishin lindur mosmarrëveshje me Nikon, të fejuarin si pasojë e thashethemeve të Sadushit. Dashuria e tyre ishte tronditur.

Sadushi qëndronte më këmbë. Dyqind palë sy e shikonin.

— Fol, Sadush, jepi llogari fshatit, — i tha njëri nga kooperativistët, — pse ke bluar si mulliri i prishur, kujt i ke shërbyer?

— Unë... unë... deshi të dredhonte Sadushi, — s'kam...

— Ti je bërë tellall, ke mbajtur njerëzit në gojë pa të drejtë, — ia përplasi një shok i brigadës. — Ne gjithmonë të kemi rënë kokës, por ty s't'u bë mbarë t'i flisje mëndjes.

— S'ke lënë njeri në fshat pa i ngjitur bisht, — shtoi Sanija, anëtarja e këshillit të gruas.

— Të kemi kritikuar sa herë... por ti ke mbajtur avazin tënd, ke llapur gënjeshtër e shpifje. Ke fejuar, ke ndarë, ke shkarkuar kryetarë e përgjegjës, ke emëruar shefa pa hesap — ia ktheu ashpër elektrikistja.

— Fol hapur para nesh! — ndërhyri një djalosh tjetër, që drejtonte mbledhjen. — Ku? kur dhe me cilët sy... e ke parë Dritën, të fejuarën e Nikos në orët e vona të natës? Dritën s'e njohim për të tillë. A i ke marrë vesh pa-sojat e shpifjes sate?

Sadushi qëndronte si mumje para katërqind syve që e shikonin. Dukej si një zvaranik, që donte t'i rrëshqiste së vërtetës, por ishte e kotë. Ata që mbushnin sallën kërkonin përgjigje.

— Unë, u... — belbëzoi me gjysmë zëri.

— Ti, ti, që e ke llapën të gjatë dhe që ke ngatërruar njerëzit, që kërkon të shkelësh edhe në dashurinë e dy të rinjve, — u ngrit i revoltuar një kooperativist i brigadës. — Ty të është zgjatur gjuha nga rehatllëku dhe nga koka që të ka zënë myk... Duhet të të presin gjuhën.

Sadushi i hutuar shikonte nga salla.

Sabriu, i mbledhur si një grusht, si iriq, ishte strukur diku nga fundi.

Sytë e Sadushit u përqëndruan të egërsuar nga fundi, në një pikë. Aty ishte Sabriu, i cili që nxirë e bërë sterrë, ashtu siç që nxirë kur e patën demaskuar si kulak në kohën që zbatohej Reforma Agrare. Ishte ai Sabri që i thoshte shpesh Sadushit: «Ti je i zgjuar, i mençur...».

— Më falni, të gjithë të më falni! Drita të më falë — tha pastaj Sadushi.

— S'kemi më as kishë, as xhami të të falim, — ndërhyri djaloshi që drejtonte gjyqin. — I kemi bërë vatra kulture. Zhvishu, zhvishu mirë para nesh!

— Unë kam gënjyer, kam gënjyer unë faqeziu, — vazhdoi sërish Sadushi. — Jam verbuar — dhe sytë i hodhi sërish, më të rreptë drejt atij që strukej akoma më thellë, drejt Sabriut, që s'gjente vend ku të futej.

— Ti ke rënë në prehërin e tij — iu kthye një nga salla.

— Unë faqeziu, Dritën ai... ai... Sabriu. Unë isha vegla e tij, vegël qorre...

Sabriu u hodh si pleshti:

— Unë s'di asgjë, ai më akuzon kot. Shpifje, shokë, shpifje!

— Ti ke hedhur gurin dhe ke fshehur dorën, prandaj mos na hidh hi syve, — ia kthyen disa kooperativistë me një zë.

Në atë mbledhje të gjithë thanë fjalët e tyre. Sadushin s'e lanë më llogaritar, por e çuan në kovaçanë, që së bashku me burgjitë e plugut të shtrëngonte edhe burgjitë e tij dhe ku koha s'i tepron të merret me llafë. Drita me Nikon të dielën e kaluar bënë ceremoninë e martesës. Në atë dasmë të thjeshtë isha edhe unë. Hodha valle, këndova me shokë e shoqe, urova çiftin e lumtur. Në doni të dini për Sabriun, puna nuk përfundoi me atë seancë. U bë edhe një seancë tjetër. Ju e kuptoni vetë, kishte hesape të tjera për të larë...

LIRIKËN E HODHËN NË FSHAT

Ajo doli nga zyrat e seksionit të arsimit me nerva të tendosura. Ishte bërë spec fare. Pikë gjaku nuk i kishte mbetur në fytyrë. E përse pa? Se e kishin caktuar mësuese në një fshat kodrinor, 18 kilometra larg nga qyteti. Ecte me të shpejtë në trotuarin e rrugës kryesore. Sa hapi derën e shtëpisë dhe hyri brenda, iu drejtua nënës, Qanijes:

— Dhe kjo më duhej tani në moshën 25-vjeçare, të bredh fshatrave, tani që dua të... Dhe kë, mua, me universitet, e specializuar për matematikë, që kam tre vjet që jap mësim nëpër shkollat e mesme!

— Ç'thua kështu, çupë e mamasë? — zgurdulloi sytë Qanija me dyshim.

— Ai e ka në dorë, babi. T'i mbledh nga i ka e nga s'i ka, me shokë e stërshokë, me miq e stërmiq, me shefa e stërshefa dhe ta rregullojë këtë punë, se nuk mban më ujë pilafi, më kupton apo jo, mama!

— Do të bëjë derman që ç'ke me të, — u hodh Qanija. — Ai ka bërë për botën e mos t'i dalë për zot evlatit të tij? Mortja që s'e ha pastaj, i rruat që është edhe shef!

— Që sonte, moj, që sonte të japë alarmin, të bien sirenat me telefon, moj, me telefon t'i zgjojë që të gjithë nga gjumi, edhe në ëndërr qofshin! — tha Lirika.

— Mos u sëmëllidis, se do të gjendet ilaçi, t'u bëftë

mamaja, se më këpute zemrën. Nuk do të pësosh gjë sa të kesh babin gjallë. Kështu, shpirt i mamasë, zemra e mamasë, e ditura e mamasë! Duan të të dërgojnë ty në fshat? Le të dërgojnë kë të duan, ka plot për në fshat nga ata që nuk dinë të lidhin... këpucët. Ti nuk ke mësuar për në fshat, se je goxha profesore gjimnazi, t'u bëftë mami!

Lirika ishte ulur në kolltuk. Qanija po pregatiste kafënë në aneksin e guzhinës. Ndërkohë u hap dera rrëmbimthi. Valbona përshëndeti dhe përqafoi Lirikën.

— U, të keqen motra, sa u gëzova që do të jemi bashkë! Sapo e mora vesh, nuk më pritej sa të të takoja, do të jemi shumë mirë!

Lirika e shikonte me habi. Akoma nuk po e kuptonte ku e kishte fjalën Valbona.

— Në gjimnaz, të keqen mamaja? E dija unë, atje e ke vendin edhe ti...

— Jo, mama. Në 8-vjeçaren e fshatit, ku kreva stazhin njëvjeçar unë — sqaroi Valbona.

— Uuu, dhe na qenke kaq e gëzuar! — ia ktheu Qanija.

— Moj, po ti si flet kështu? Kam dëgjuar se je edhe kaparosur, po të lë ai bandilli të vesh në fshat?

— Si, moj, s'më le, ai në fshat është për vete!

— Pse, e shkurtuan edhe atë? — pyeti Qanija si me keqardhje.

— Jo, mama, ai është vendës, — ndërhyri Valbona — Është nga po ai fshat. Atje u rrit, atje shkoi, pranë tokës.

— Ç'punë bën? — u bë kurioze Qanija. — Do të jetë i madh atje, hë?

— Kooperativist, brigadier i brigadës që arrin rendimentet më të larta në kooperativë. Ka mbaruar shkollën e mesme pa shkëputje nga puna. U njohëm kur bëja stazhin.

— Je nxituar shumë, Valbona, ndërhyri Lirika. —

Ti je simpatike, elegante, kishe mundësi me sytë e me shikimet e tua t'i rrëmbeje zemrën ndonjë mjeku, inxhineri ose artisti.

— Ua rrëmbeje, të keqen Qanija, ua rrëmbeje e s'ua lëshoje, kaq ta bënin dhëmbin!

— Qytetit më mirë thuaj, — ndërhyri sërish Valbona. — Ju më thoni të vë interesin mbi dashurinë, mbi ndjenjat, të përçmoj një njeri të ndershëm. Kështu mendoni ju? Shumë keq! Unë po iki! Por është mirë të ndërrosh rrugë, Lirika. Ti... ti duhet t'i flakësh këto mendime, që vijnë era myk. Mirupafshim në fshat!

Dhe iku. Nënë e bijë mbetën një copë herë si të nemitura. «Po kjo?» sikur thoshnin sytë e tyre.

— Do ta rregullojë Qazimi se s'bën punën tënde, Lirikë! Ja tek po duket, ia them unë që tani... Po hajde, mor burrë, ç'u bëre? Kurrë s'të ka njeriu për një hall a një dert.

— Po ja, moj grua, se kemi edhe punë shtetërore! Ti, Lirikë, ç'ke kështu? Të shoh të mërzhitur.

— E kanë degdisur në fshat! — tha Qanija.

— Në aksion njëmuja, besoj. Shumë mirë, ti Lirikë ke nevojë të kalitësh.

— Ç'njëmuja, mor ditëshkurtër, e kanë çuar mësuese andej tutje.

— Shumë bukur — qeshi Qazimi. — Do të vemi edhe ne nganjëherë.

Qanijes po i vinin dhe i iknin njëqind ngjyra në fytyrë. Lirika çaploi sytë.

«Ç'është kjo punë kështu? Është në terezi ky burrë, apo ia ka bërë fiu», mendoi Qanija.

— Grua, edhe fshati për ne është. Nuk e dëgjon radion, nuk e shikon gazetën? Po bëjnë mbledhje përditë. Fshati do të lulëzohet akoma më shumë. Nga kush? Nga ne, nga Lirika. Prandaj ajo të vejë atje ku e kanë caktuar.

— Qazo, politikë po më bën? Po burrë ku do të gjejë vajza?

— Atje në fshat ka plot agronomë, kooperativistë, veterinerë, mësues.

— Ke vendosur të tallesh me mua? — ndërhyri ashpër Lirika. — Atëhere unë do ta rregulloj vetë, qysh nesër në mëngjes. Në seksion kam një shok që është inspektor. Kam mbaruar shkollën me të. Ai do të më ndihmojë.

Të nesërmen Lirika trokiti dhe hapi derën e inspektorit. Në krye të tavolinës qëndronte një burrë i qeshur, i veshur thjesht, i rreshkur nga rrezet e diellit.

— Shok, ju lutem, i patë gjë këta shokët e zyrës? — iu drejtua Lirika.

— Kë kërkoni, shoqe? Urdhëroni brenda!

— Ju jeni mekanik në uzinë, apo jo? Unë ju kam dhënë mësim natën juve! — tha Lirika me habi.

— Po nuk do të thotë gjë, shoqja mësuese. Dje mekanik, sot inspektor, nesër kooperativist.

Lirikës sikur e përvëluan këto fjalë.

— Ku mund ta gjej inspektor Agronin? — ndërhyri përsëri Lirika.

— Në sheshin kryesor të qytetit. Sot do të nisët për në malësi, në zonat e thella, bashkë me shumë arsimtarë të tjerë. Tani eja të shkojmë bashkë në ceremoninë e nisjes.

Lirika u nis së bashku me të në sheshin kryesor. Aty u takua me ish-inspektor Agronin dhe me shokët e tjerë, që po niseshin për në malësi.

Që të nesërmen, Lirika së bashku me Valbonën u nisën për në fshat, për të bërë regjistrimet. Natën e kaluan të gëzuara në shtëpinë e brigadierit të rendimenteve të larta dhe panë në televizor filmin artistik shqiptar «Komisari i dritës». Pas ca ditësh Qanija vajti për të ndënjur një javë në fshat me Lirikën...

O DENTISTE, O FARMACISTE!

Salla ishte mbushur plot. Atë ditë në lagje bëhej mbledhja për dhënien e të drejtave të studimit për në shkollat profesionale. I pari e mori fjalën kryetari i presidiumit të mbledhjes.

— Shokë! — tha ai. — Në fillim do të shqyrtojmë nxënësit Flora Mimoza dhe Genti, që e mbaruan shkollën me të gjitha notat dhjeta. Ne kemi mendimin që Flora të vazhdojë teknikumin për metalurgji, Genti teknikumin e naftës, ndërsa Mimoza bujqësozin.

Aty nga mesi i sallës kërceu përpjetë një burrë. Ishte Ashafi. Siç dukej ai kishte vendosur të fliste pa leje këtë herë.

«Si! Flora të bëhej metalurge? Po ku është parë kjo, more!» Këto ishin mendimet e para që i erdhën atë çast Ashafit. «Metalurge! Posi! Të vinte nga puna me duart tërë kallo e zgjyrë? Kurrë! Ajo kishte lindur për të mbajtur bluzë të bardhë. Ajo, Flora...»

— Ulu! — i thanë ca nga fundi. — Ulu, ulu — i thanë edhe ata të presidiumit. — Merr leje kur të flasësh. — Por Ashafit i kishte hipur gjaku në kokë.

— Nuk ulem, sepse vajza ime, Flora, e ka notën mbi dhjetë! — tha ai. — Në mos gabohem, dhjetë e kusur, dhe i takon dega me numër një.

— Sepse është me dhjeta, prandaj edhe ne menduam

që të mësojë për metalurge, — sqaroi një nga të presidiumit.

— Nuk jam dakord, në asnjë mënyrë nuk jam dakord! Ç'do të thotë kjo? Notat e vazjës sime flasin për një dentiste, se këtë zanat e kemi pasur si talent edhe si tua. Gjyshi im, derisa mbeti pa dhëmbë në gojë, darën nuk e ndau nga dora; u shkulte dhembët çak-fap miletit. I ndjeri baba ua hiqte edhe me spango! Bëni hesap vetë, unë kam hequr 20 e ca dhëmbë e dhëmballë si dhe dy dhëmballët e mia të syrit, ndërsa vajza, me sa kuptoj, ka aq shumë prirje, sa ta bën gojën shyt fare kur të duash. Pale kur e ndihmoj edhe unë jashtë orarit!

— Për dentiste mund të shkojë edhe një me notë pak më të ulët, — ia priti njëri. — Rëndësi dhe kërkesat e metalurgjisë janë më të mëdha.

— Në mos dentiste, farmaciste do të bëhet medoemos Flora ime. Ajo latinishten e di përmendsh, më ka mësuar edhe mua rreth katër llafe, — nuk dorëzohej Ashafi.

— Mos harro se përveç fjalëve latinishte që ke mësuar, ti vuan edhe nga ndikimet e huaja, shoku Ashaf! — iu drejtuan atij nga salla.

— Me leje! Jam dakord që vajza ime Mimoza të shkojë dhe të vazhdojë për agronome, të veshë pantallonat dhe t'u bjerë fushave mes për mes — u ngrit e tha Ylli. — Edhe bujqësia kërkon kuadro nga më të mirët. Por ama nuk jam dakord me ato që ngre Ashafi. Ne e kemi dëgjuar edhe herë të tjera, na ka folur dhe na ka mbajtur leksione për zhvillimin e industrisë, për veprat e reja, për bujqësinë e modernizimin e saj. Por, meqë latinishten vajza e tij e di në majë të gishtrinjeve, propozoj që ajo të vazhdojë studimet për veterinerë.

Ashafi u hodh përperjetë për të tretën herë.

— Si the? Për veterinerë? Veterinerë me notën dhjetë? ! Vajza ime të merret me kafshë? ! E me ç'gjuhë do të

merret vesh? Të paktën as nuk thoni për dentiste kafshësh, meqë denticllëkun e kemi pasur traditë nga gjyshi. Ç'bëni, more shokë, ç'thoni, or të uruar!

— Ju falenderoj që djalin tim, Gentin, keni menduar ta dërgoni për teknik naftë, — tha Gëzimi. — Ai ka dalë me dhjeta, dhe atje prapë me dhjeta do të dalë! Nafta është gjaku i industrisë sonë. Ndërsa Ashafi e ka shumë gabim. Me diskutimin e tij ai po bëhet qesharak, sepse...

— Ashafi kërceu për të katërtën herë, sikur ta kishte pickuar ndonjë insekt i rrezikshëm.

— Me leje, shokë të presidiumit? — tha ai.

— E kam unë fjalën! — u dëgjua një zë vajze nga fundi.

— Mos u mërzit, prit, çupë e babait, se e sqaroj unë punën, — i tha Ashafi.

— Mjaft prita, — ia ktheu Flora, — dhe mjaft të dëgjova! Shokë! Do të shkoj metalurge dhe ju jap fjalën se do ta justifikoj besimin tuaj! Po, do të bëhem metalurge!

Thonë se që nga ajo ditë Ashafi hoqi dorë nga latinishtja dhe iu fut me zell të madh metalurgjisë.

ZEMRA E TIJ ISHTE DËMTUAR NGA REHATIA


Dalipi është burrë. E vërteta është se që kur ka lindur, në asnjë poliklinikë të vendit nuk gjendet ndonjë diagnozë në kartelën sanitare të tij. Pa le pastaj t'i ketë bërë vaki t'i turret Dalipit ndonjë mikrob i pamëshirshëm, për t'i kërcënuar jetën! Pra, në vija të holla ose të trasha Dalipi ishte top.

Kishte më se 10 vjet që kishte zënë rrënjë në një nga ato karriket e Pogradecit. Me një fjalë, Dalipi ishte shef. Për hesape të thante, i bënte me sy mbyllur e me sy hapur. Edhe me gishta, edhe pa gishta. Kishte edhe një diplomë të mesme, të cilën e mbante në kasafortën e zyrës. Thonë se Dalipi e nxirrte tri herë në ditë nga kasaforta e tri herë në ditë e puthte me mall të madh.

«I thonë diplomë», mendonte Dalip trupgjigandi, duarbuti. «Po të mos ishte kjo e uruar, kushedi se nga do të grasatoja makinat!»

Por këtu e dy javë të shkuara, në diskutimin për rishikimin e organikave dhe të hallkave të tepërta, punëtorët propozuan që vendi i shef Dalipit, me vendin e zëvendësshef Magripit të shkriheshin në një të vetëm, ose më troç Dalipi dhe Magripi të lëshonin karriket dhe punën e tyre ta bënte dikush tjetër.

Ky propozim i studjuar nga grupi i kontrollit punëtor mbështetej në këto fakte: gjatë 480 minutëshit Magripi pinte katër kafe, ndërsa Dalipi pesë, tri të mesme dhe dy



me pak. Magripi kishte 43 formularë, nga të cilët për nevojave konkrete duheshin 21, ndërsa Dalipi mbante 49 përqind të formularëve origjinalë, sigurisht ata më seriozët, të cilët ndodheshin edhe në dosjen e zëvendësshefit, Magripit. Thonë se shef Dalipi mbante dhe një zinxhir, që heraherës e dridhte, para ose pas buke. Magripi katër deri në pesë herë ishte bërë gati të blente një palë tespie, por nuk i qe bërë mbarë, se ato të flamosura i kanë flakur tej edhe ata pleqtë e moçëm.

E kështu u vendos që Dalipi të kalonte drejtpërsëdrejti në prodhim, ndërsa Magripi t'i harronte tespiet...

Por Dalipi nuk ishte dakord të kalonte në prodhim. Nuk ishte ai taman për në prodhim. «Unë në prodhim, unë i sëmuri»? — u ankua Dalipi kur u muar vendimi. — Unë vuaj shumë nga zemra, le mëlçinë që e kam trokë; pikë gjaku nuk më ka mbetur! Jam keq!»

Të gjithë shikonin me habi barkun e tij, që kishte kërcyer përpjetë!

«Jam me raport nga zemra, shokë! — thoshte Dalipi. — Ja ç'ka shkruar kardiologu rheumocarditis!»

— Me raport?! Ti, Dalip, me raport për punë të lehtë? Ti, Dalip, që s'e ke provuar «cëken» nga infermieri? Mos të ka zënë sëmundja e rehatisë? — i tha shoqja Vita, ajo vajza që kishte kaluar para tre muajsh në prodhim vullnetarisht dhe që tani bënte pjesë në komisionin e kontrollit punëtor.

— Është zemra, moj shoqja Vita, zemra personale!

— Do t'ia gjejmë edhe zemrës sate ilaçin — iu përgjigjën punëtorët Dalipit. Dhe ata i rekomantuan të shkonte në komisionin medikolegal. Dalipi shtangu.

«Unë... Në komision?! Ta zëmë se ai mjeku zemërgjerë i zemrës sime prapë do të mbyllë syt, po ata të tjerët? Ata nuk do të qëndrojnë symbyllur!»

Kështu thoshte Dalipi me vete dhe skuqej e bëhej flakë...

Të nesërmen në mëngjes, Dalipi mblodhi 49 përqind të formularëve seriozë që dispononte dhe ia dorëzoi shoqes që e zëvendësoi. Zinxhirin ia dha rojes së natës, por ai qeshi me tallje, së asnjëherë nuk e ka dredhur. Në kohën e lirë ai vadit lulishten para ndërmarrjes.

Dalipi përveshi mëngët. Javën e parë e pati pak të vështirë, po tani që është skuqur edhe nga rrezet e diellit, po e realizon normën 101 për qind. Frekuenton në rregull kursin e kualifikimit për motorist. Po ta pyesësh, thotë: «Tani e shoh se i shërbej shoqërisë, vëllezër! Tani që djersa i shërben punës...»

Po Magripi? Meqë nuk «vuante» nga zemra, shkoi menjëherë në oficinë. Aty i pa me sytë e vet ato detale që mbushnin formularët e tij. Jo vetëm i pa, por edhe nisi t'i prodhojë me punëtorët. Po për kafe si ia bënte? E kuptoi përgjithmonë se ato i piheshin për të «plotësuar» kohën e punës.

Komisioni i kontrollit punëtor e vazhdoi punën e tij edhe më tej. Në spital bëri një ballafaqim tjetër. Mjekut të zemrës iu drodh zemra kur e pa. Pas atij ballafaqimi ai e la poliklinikën e qytetit dhe u dërgua për të punuar në një fshat malor, se atje ka ujë të ftohtë...

DOLLAPI I VEQOS DHE I ZEQOS...

Që kur u emërua brigadier në brigadën xhenerike të parkut të mallrave, Veqos iu dha edhe e drejta e firmës për tërheqjen e materialeve në magazinën e pjesëve të këmbimit. Filloi të firmosë e të vulosë vetë. Bleu edhe një laps me dy ngjyra, kuq e blu. Për përdorimin e këtij lapsi me «vend e me mend» e pa të udhës të konsultohet me Zeqirin, ose më shkurt me Zeqon.

E ç'nuk firmoi me lapsin kuq e blu dora e brigadierit!

— Ore Zeqo vëllai — tha Veqoja një ditë Zeqirit — po kjo magazina jonë qenka supermagazi! Ç'nuk ka brenda, more xhan i vëllait, qumësht dallandysheje, Zeqo, qumësht dallandysheje dhe unë mavria s'kam ditur gjë fare!

— Ashtu është, — i ishte përgjigjur Zeqoja. Unë e kam ditur që kur ra dielli i parë mbi këtë magazinë, po halli se s'më shkonte fir... Ka aty për ndërmarrjen edhe për ne. Nuk soset, o Veqo vëllai, jo, nuk soset... malli i shtetit.

Ditët kalonin, miqësia forcohej midis brigadierit dhe «zëvendësbrigadierit» të emëruar nga vetë Veqoja. Miqësi për kokën e miqësisë. Brigadier Veqoja gërr lapsit blu dhe furnizohej nga magazina me llampa, stopa, folio e kontrafolio, balestra. Ç'nuk dilnin çdo ditë nga ajo derë!

Hajde, Zeqo, hajde, fringo të reja janë, gjynah që t'ua vemë makinave...

— Ashtu janë, ia kthente Zeqoja — po... Këto i shet kur të duash ditën dhe natën, me hënë dhe pa hënë. Ka nevojtarë plotë, kush nuk i blen!...

— T'i shesim?! — u habit brigadier Veqoja — ku t'i shesim?

— Ma lër mua këtë punë — i tha Zeqoja si me shaka nga frika se mos ja kthente brigadieri, por kur e pa se e kishte me tërë mend edhe Veqoja, Zeqoja qeshi: — Hi! hi! hi! Ti vetëm firmën vëre, daç me të kuq, daç me blu.

— Mirë, o Zeqo, s'e ke keq, për kokën tënde — Dhe i ndanë detyrat.

Zeqoja filloi të ecë serbes-serbes në këtë rrugë të pashkelur «Usta» Zeqoja u «mbyll» në dollap. Aty do të vinin, siç duket edhe mendime të tjera gjeniale për të gjetur marifetet «e qarkullimit» të materialeve. Pas dy orësh u kujtua që ishte atje. Aty për aty i lindi ideja: në rolin e magazinës të kthente dollapin. «Hajde, Zeqo, hajde, — i tha vetes, — i tmerrshëm je, për kokën tënde!»...

Zeqoja ishte vërtet «i tmerrshëm». Një herë, që nga brigada, e ndjeu erën e një makine ngarkuar me portokalle, që u fut në portën e parkut. Me mjeshtëri iu turr, mori portokalle sa deshi dhe... e hodhi lumin pa u lagur fare. Një herë tjetër u vuri syrin ca llamarinave. Edhe këtë herë «shpëtoi nëpër fiq». Po tani? Hë, hë, hë, tani e di vetë ai se si të fshihet. Eksperiencën për këto punë e ka të madhe. Vetëm një gjë e mundonte: po sikur ndonjë «i paudhë» t'u hapte dollapin me ndonjë çelës, pastaj... iku pasuria! Po ai ishte saldator me kategori serioze. Ja që i erdhi radha «shpikjes» së tij të parë.

Për dollapin nuk përdori më çelës, por saldim, saldim

saldim... Në mëngjes shqepej dhe mbushej, kur binte hëna boshatisej e ngjitej. Ngjit e shqit e shqit e ngjit.

Kështu vazhdoi puna me këtë dollap. Brigadier Veqoja, Zeqoja dhe dollapi salduan pa oksigjen një miqësi. Materialet delnin nga magazina nëpërmjet Veqos tek Zeqoja dollapit dhe dollapi i kthente në... lekë. Të gjitha këto «hyrje e dalje» spuntoheshin me lapsin blu të brigadier Veqos.

Por një ditë plot diell e dritë, si çdo ditë tek ne, i erdhi radha edhe lapsit të kuq: Kolektivi i brigadës dhe i gjithë parkut i shënoi emrat e Veqos dhe të Zeqos si vjedhës të pasurisë socialiste. Pak ka si Veqoja e si Zeqoja, po edhe këta të pakë «ustallarë» të tillë po i fshin fshesa e hekurt e kontrollit puntor.

KUR MERAKU I DIMRIT TË ZE NË BEHAR

Ç'eshtë e vërteta, mua çdo gjë e bukur më tërheq, prandaj doja si e si ta zbukuronim ndërmarrjen tonë të re, të krijonim një ambient të bukur e të gjallë. Më dukej me vend që në hyrje të ngrinim një stendë të madhe për qendrën e emulacionit. Ta themi midis nesh, unë nuk gëzoja ndonjë funksion shoqëror dhe as i ngarkuar me emulacionin nuk isha, por kjo nuk donte të thoshte që të mos mendoja fare për parullat, për stendën, për gjithshka duhej rregulluar në ndërmarrje.

Në fillim vendosa të merrem me stendën. I shkova drejtorit një ditë në zyrë që t'i shtroja nevojën e ndonjë fondi të vogël për rregullimin e saj. Drejtori më mirëpriti dhe më përgëzoi për këtë aksion individual që kisha marrë.

Thirra Naqon dhe të dy u nisëm në një nga uzinat e qytetit tonë. Sa hymë në oborrin e madh, rrethuar nga të katër anët me drurë hijerëndë, Naqoja s'priti sa të takonim ndonjë nga të njohurit që kishim atje, po e mbajti frymën drejt e te stenda. Duke e parë ai ia dha të qeshurit.

— Gaqi, o Gaqi! — më thirri që përtej. — Pa eja pak këtu!

— Ç'ka bërë vaki? — e pyeta dhe iu afrova me kurreshtje.

— Shikon? — ngriti gishtin tregues ai drejt një fotografie të madhe diku në stendë. — Paskan nxjerrë njërin me syze të thyera!

— Do të jetë pamje nga grupi i estradës.

— Jo, për nder jo! Ja, edhe emrin këtu poshtë...

Zgjata kokën dhe u përqëndrova mbi fotografinë. E njihja mirë njeriun me syze të thyera, kisha pirë edhe kafe me të, po ç'ne ai me syze në fotografi? Ai i uruari s'kishte vuajtur ndonjëherë nga sytë, madje me çifte të thante, e qëllonte pesëdhjetëqindarkëshen dyzet metra larg. Ja dhe një datë, po ajo, për çudi, të çonte shumë kohë prapa. U hutova fare. Por në kohën që po vrisja mendjen për të kuptuar diçka, më erdhi në ndihmë Naqoja.

— Është viti 1972, po nënta ngjan si tetë. E ka zënë pluhuri, ndërsa syzet ia kanë shtuar agjentët atmosferikë.

— Tamam, ai qenka dora vetë, Nasi! Sa paska rënë këto tre vjetët e fundit!

Lexojmë motivacionin: «I dalluar për rezultate të mira në shkollën e mbrëmjes...»

— Nuk është Nasi, — thashë prapë me dyshim. — Ai ka tre vjet që e mbaroi shkollën tok me mua.

— Mos e ka filluar prapë? — tha Naqoja.

— Nga e para? Hajde vullnet, hajde!

Në krah të shokut tim rrinte fotografia e një vajze me një sy pak si të mbyllur.

— Ou, Liria, — tha Naqoja, — qenka transferuar prapë këtu! Ka dy vjet e kusur që është martuar në Tiranë, po siç duket do të ketë ardhur përsëri me burrin në qytetin tonë. E kam dhe kushërirë e s'paskam dëgjuar gjë! Po syri ç't'i ketë, xhanëm?

Lexojmë motivacionin: «E dalluar në lëvizjen artistike...»

— Sa e ndien muzikën! — thashë unë. — E shoh si e ka mbyllur njërin sy?

— Mos u tall, — tha Naqoja — se këtë fotografi e kanë zënë hallet e kësaj të shokut tënd...

U futëm brenda në uzinë dhe filluam nga mensa, meqë ajo ndodhej aty afër. Brenda në guzhinë ishte ngjitur një parullë me këtë pëmbajtje: «Të mekanizojmë proceset e punës».

Naqoja më ra me bërryl.

— Pa lexoje!

— Ku e gjen, — i thashë unë, — të na futen makaronat automatikisht në gojë! Të mekanizojmë pjatat, kusitë, lugët, tenxheretë, pasi...

Dolëm nga guzhina dhe u futëm në korridorin e magazinës. Në derë ishte ngjitur një alamet table: «Ndalohej rreptësisht hyrja në magazinë». Kjo na bëri që t'i drejtoheshim sportelit. Duke zgjatur kokën, aty nga fundi, më zuri syri një tabelë tjetër: «Ndalohej duhani brenda në magazinë!»

— Ore Naqo, — i thashë. — Po këtu është e ndaluar hyrja, për kë ndalohej duhani, kur nuk hyn njeri?

— Me siguri magazinieri ka vendosur të presë duhanin. E, që të mos e ndezë, e ka me të shkruar dhe puna është në rregull, — tha Naqoja.

Naqoja, si më vigjilent që ishte, në një cep tjetër të magazinës vuri re një shënim tjetër: «Shokë punëtorë, shfrytëzoni 480 minutëshin, koha është flori.»

— Hajde flori i mbyllur në magazinë, hajde! — tha ai.

Largohemi nga magazina. Diku lexojmë: «Shokë! Muaji janar është në përfundim e sipër, prandaj merrni masa për të mbyllur me sukses tremujorin e parë të këtij viti shkollor...»

— More Gaqi, po kësaj ç'i thonë? Tani jemi nga fundi

i vitit shkollor, ç'hyn janari në këtë mes? Tani sapo filluan regjistrimet. . .

— Siç duket paralajmërojnë për janarin që vjen! Pse jo? Ku e gjen që meraku i dimrit të të zërë në behar. . .

U nisëm për të dalë, po ja se s'ke ç't'u bësh syve kur ata shikojnë! Mbi xhamin e një dritareje të madhe pamë të shkruar me gërma të mëdha; «Gëzuar Vitin e Ri 1975! Suksese. . .»

— More, more, sa vonë ardhka Viti i Ri këtu! Ne andej po bëhemi gati për 1977-tën, — i thashë Naqos.

— U bëjmë një fletërrufe?

— U bëjmë, — i thashë unë.

Ashtu bëmë. E ata na kthyen përgjigje: «Gjithshka që kishte të bënte me propagandën e prodhimit në uzinë e freskuam. . . Ju falenderojmë, shokë. . . se u freskuam edhe vetë!»

TË DREJTON E TË TREGON VENDIN GRUAJA

Këtu e ca kohë të shkuara Shefki Kotri ra në një sëlëndi të madhe. Ndodhi kjo një mbrëmje vjeshte, kur sapo ishte kthyer nga ara e aty, para vatrës së kulturës, veshi i zuri dy-tri fjalë që e shtangën në vend: Sanija do të bëhej përgjegjëse e sektorit! Sanija përgjegjëse sektori?! Kjo ishte pyetja e parë që i erdhi në kokë Shefkiut. Ai iu qas më pranë atyre që bisedonin, për të dëgjuar më mirë. Po, ishte e vërtetë. Ata vërtet po thoshin se Sanija ishte propozuar për përgjegjëse sektori, pikërisht ato ditë kur ai ishte larguar nga kooperativa dhe merrej me hallet e tij poshtë e lart nëpër qytet.

— Sikur s'dëgjoj mirë nga veshët, pa më thoni edhe një herë. Sanijen do të zgjedhin përgjegjëse? — ndërhyri si me të qeshur Shefkiu.

— E mbarove pazarin ti, atë shiko! — i tha një djalosh rreth të njëzetave dhe u shkeli synë shokëve.

— Pazarit është puna ime, — u hodh e tha rëndë-rëndë Shefkiu, — po pa më thoni, mos u ka rënë flama burrave këtu në fshatin tonë që të vëmë në krye të sektorit një vajzë?

— Sa mirë i vajti mendja! — u hodh aty për aty djaloshi dhe prapë ua bëri me sy shokëve. — More si xhanëm nuk propozuam Shefkiun për përgjegjës! I punës,

i pari i fshatit, i muhabetit! E ka për nder qoshenë, qytetin e njeh pëllëmbë për pëllëmbë! Harrova, se edhe në bujqësi s'ia gjen shokun.

Shefkiut i dogji, por nuk e dha veten. Në fillim bëri sikur qeshi dhe u përpoq që ta zbuste pak gazin që shpërtheu në grupin e kooperativistëve.

— Mua s'm'u hap barku për përgjegjës sektori, nuk e kisha këtu llafin. Të zgjedhim, ore, burrin më të mirë që ka fshati! Pse, na komandon dot një grua ne? Gruaja është për të larë rrobat ose e shumta për të mbledhur pambuk dhe jo për të drejtuar!

— Shefki, të kanë zënë trutë myk! — iu hodh një nga ata. — Ke mbetur prapa botës, o derëbardhë!

Por Shefkiu nuk u dorëzua, ai u largua nga grupi i kooperativistëve dhe filloi të llototisë poshtë e përpjetë: «Na rrofshin mustaqet! Ç'ju thotë mendja, more shokë! Po pse, të keq e kemi Tolin që t'ia zëjë këmbën një çupë? Kjo nuk është parë e nuk është dëgjuar. Unë nga imja nuk heq dorë. Dhe jo vetëm unë, por të gjithë ata që janë burra. Një copë piciruke do të na japë mend, të na mësojë agronomllëkun? Dhe kujt, neve bujqërve, që i dimë të gjitha në majë të gishtërinjve: sa kokrra do të bëjë kalliri i grurit dhe sa ai i misrit! Hëm, thonë që të arrijmë të marrim 45 kv grurë dhe 95 kv misër për ha dhe na vënkën në krye një çupë! Ua tregoj unë në mbledhje, po hajde!»

Pati edhe dy-tre, që ecnin pas mendjes së Shefkiut, por të tjerët vinin buzën në gaz, i hidhnin ndonjë rromuz dhe as që ia zgjatnin shumë.

Me këto mend, të nesërmen Shefkiu shkoi në mbledhjen e përgjithshme. Si zuri një cep aty nga fundi dhe, si dëgjoi katër a pesë vetë që u ngritën dhe e përkrahën me një zë propozimin për Sanijen, Shefkiu kërceu përpjetë e në fillim i hodhi sallës një vështrim hijerëndë.

— I keni menduar të gjitha, shokë? Dëgjomëni mua, se nuk është vonë! Do ta katandisim sektorin në bisht të kooperativës! Ka rregulla këtu. Nuk na drejton dot një grua, e aq më shumë një vajzë e re!

Disa nga ata që ishin pranë tij vunë buzën në gaz, kurse dikush nga prapa e tërhoqi nga cepi i xhakëtës.

— Ke më? — e pyeti Lumturia që kishte zënë vend në presidium. — E kemi dëgjuar këtë pllakë gramafoni, shoku Shefki dhe nuk është mirë ta rrotullosh prapë.

Në sallë qeshën me të madhe. Shefki u mundua diç të kundërshtonte, po e kuptoi që nuk po ia varte më njeri. U mundua të thërriste përsëri «mblidhni mendjen», po atëkohë fjalën e kishte marrë nënë Marija, që punonte në brigadën e katërt, ku kishte punuar edhe Sanija.

— Të lash gojën me sheqer para se të përmendësh emrin e Sanijes sonë! Dëgjon! E kemi rritur vetë këtë çupë, ia dimë të tëra të mirat, nuk na turpëron ajo ne. Do të na nxjerrë faqebardhë dhe ti, Shefki, dëgjo këtu: Meqë nuk do të dalë llafi yt, ta bëjmë me një kusht: të mos i mbash më mustaqet!

Në sallë krisën përsëri të qeshurat dhe Shefki nuk dinte ç'të bënte. U mat një herë të ikte, po pastaj i dha zemër vetes: «Këtu jemi, do ta s'nohim!»

Ditët e para Shefkiu priste që Sanija të mbyllej tërë ditën e ditës në zyrë, të hapte dosje e të merrej me shkresa, ashtu siç kishte parë të bënte Toli kohët e fundit. Bënte, ç'bënte dhe kalonte Shefkiu ndonjëherë, kur i binte rruga, aty nën dritaret e zyrave të sektorit, po Sanijen nuk ia zinte syri. Ajo, kur Shefkiu s'ishte përmendur akoma nga gjumi i thellë i mëngjesit pasi hidhte forcat në punë, rrëmbente edhe vetë shatin dhe punonte në ndonjërën nga brigadat. I qëllonte që edhe në zyrë të rrinte por këtë e bënte kur ishte e nevojshme dhe jo di-

tën, por në orët e vona të natës. Tri herë në javë koope-
rativistët e shikonin atë të merrte rrugën për në tekni-
kumin bujqësor.

Muajt ia linin vendin njëri-tjetrit. Më kot priste
Shefkiu që t'i dilte ndonjë nga llafet që kishte nxjerrë.
Gruri po merrte shtat si asnjëherë. Të hyje në mes të
tij, gati nuk dukesh fare, që bërë për sevda, i shëndet-
shëm. Një mbrëmje dëgjoi që i thirri nga pas nënë
Marija.

— E, Shefki, të iku merak? Apo akoma po bluan me
mendje se cili burrë do të zërë vendin e Sanijes?

Shefkiu nuk ia ktheu dhe vazhdoi rrugën. Në mbrëm-
jen e po asaj dite, atij i doli përpara Toli, ish-përgjegjësi
i sektorit, që tani punonte (dhe punonte mirë) si koope-
rativist i thjeshtë.

— More Toli, — i tha Shefkiu, — na qenka qerrata
vajzë! Ku i ditka të tëra ajo!

— Jeta t'i mëson të gjitha — u hodh aty për aty Toli.
— Kush e harron këtë gjendet edhe ilaçi për t'ia kujtuar.
Ja, si puna ime...

Pastaj erdhi koha e lëmit, Jo 45, po 50 kv grurë për
ha. mori sektori i tyre. Për këtë rendiment të lartë që u
arrit, u bë edhe një aktiv i zgjeruar. Erdhën kooperati-
vistë nga i gjithë rrethi dhe një ndër ata që e morën fja-
lën, siç më thanë, ishte edhe Shefki Kotri.

«Më shihni mua? — kishte thënë ai. — Unë jam ai që
jam ngjirur, por sot nuk kam llafe për të thënë, se llafet
janë pa bereqet. Veç një gjë do t'ju them, more shokë:
qenkan e ç'qenkan gratë! Të drejton gruaja që ç'ke me të
dhe të tregon vendin siç ma tregoi edhe mua...»

Thonë se Shefkiu i rruajti edhe mustaqet, se nuk iu
nda nënë Marija. Po, meqë nuk e kam takuar, këtë nuk
e them dot me siguri.

KANË HALLE DREJTUESIT E SPORTIT

Klubi i sportit ndodhet në mes të qytetit. Një ndërtesë e bukur midis gjelbërimit rrëzë një kodre. Në këtë godinë të skalitur nga dora e muratorit, të mbuluar me topa e kamardare, flenë gjumë ditë e natë nja dy trainerë dhe nja dy drejtues të fiskulturës. Kur u del gjumi, ata drejtojnë me guxim e shpresë të gjitha ekipet që konkurojnë denjësisht në kategorinë e tretë, ato ekepe që s'u trembet syri nga kategoria e dytë dhe ato ekepe që kanë zënë me tapi vendin e fundit në kategorinë e parë. Ata presin të drejtojnë dhe ato ekepe, në ato lloj sporti, që akoma nuk kanë zënë pikë në hartën e fiskulturës në qytetin tonë.

Noti u ka hyrë në qejf këtyre drejtuesve; beharin që do të vijë kanë vendosur të krijojnë një ekip noti, ku pjesëtarët do të mësojnë «digidum», not qeni dhe not peshku, në plazhin afër qytetit. Edhe volejboli u ka hyrë në gjak. Për këtë kanë vendosur të gjejnë edhe një trainer.

Në kërkim të trainerit të ardhshëm janë shpërndarë gjithë ciklistët e dalluar në drejtime të ndryshme, por deri më tani kërkimet nuk kanë dhënë gjë konkrete, prandaj së shpejti në kërkim të trainerit do të marrë fletudhëtimi motoçikleta e fiskulturës që destinacionin kryesor e ka për peshkim dhe gjueti. Meqë ra fjala për gjuetinë, shokët e fiskulturës së shpejti do të fusin në listën e aktivi-

teteve gjuajtjen e peshkut lavrak dhe të dhelprës qimekuqe, për të zënë vendin e parë në kategorinë e parë. Mundësitë janë që dëshira të realizohet, sepse disa nga këta punonjës të fiskulturës kanë traditë në këto lloje sporti, me rrjetë e me grep si dhe në gjuajtjen me çifte.

Futbollistëve nuk ua ka njeri fajin. Ekspit të qytetit tonë, që po mban me të dy duart bishtin e tabelës së klasifikimit s'i kanë ndonjë faj. Thonë se futbollistët janë majmur e do të na dalin skarco, prandaj «o burra, t'i kthejmë në mundës, meqë edhe ekipi i mundjes nuk paraqitet mirë!»

Për basketbollin tonë ata «të rrojnë vajzat, se djemve nuk u ka njeri faj, koshat nuk ua kanë marrë. Ç'kanë që po ngopen me nga 101 pikë?»

«Në atletikë — thonë prapë ata — puna qëndron ndryshe. Në garat e vrapimit, në kërcime, në hedhjen e gjyles, të diskut, të shtizës, nuk kemi rezultate... por ama për këtë nuk kemi faj ne, drejtuesit e fiskulturës, sepse nuk ua kemi ndaluar që t'ia veshin me vrap, nuk kemi ndaluar asnjëri, djalë apo vajzë qoftë, burrë apo grua, plak apo plakë, që të hidhen përpjetë dhe që të zënë vendin e parë në këtë lloj kërcimi!...» Këtu, shokë, ta themi midis nesh, kanë ndaluar vetëm kërcimin përpjetë të atyre që i kanë kritikuar në mbledhjet e kolektivit, vetëm ata e kanë humbur të drejtën e kësaj gare.

Në hedhjen e gjyles janë në hall: kërkojnë një njeri që të mbajë shtatë deri më tetë qillo në pëllëmbë të dorës. «Po u gjet një njeri i tillë, — thonë ata, — rezultatet shpresohet që të jenë të larta. Vetëm ata të diskut le të rrinë në disk, ndërsa për shtizën së shpejti do të merren masa konkrete...»

«Ja, more vëllezër, — thonë drejtuesit e fiskulturës — kemi gjithë këto skuadra, veç atyre që s'kemi. Sa për cilësi, të na rrojnë basketbollistët e rritura.»

Por, si thonë «me një lule s'vjen behari». E, që të vijë behari në këtë komitet fiskulture me shumë lule, është vendosur që çdo të diel, në pyllin e lajthive, të bëhet stërvitje me qitje me çifte. Motoçikleta s'do të lërë kurs për të gjetur një trainer volejboli dhe së bashku me futbollin dhe basketbollistët e rritur do të bëjë numra të fortë, derisa t'i marrin frymën topit.

P. S.

Në vend të rubrikës sportive, në pamundësi për t'u lidhur direkt me stadiumin e qytetit tonë (që me siguri ka qenë i mbushur plot e përplot me spektatorë për të parë koshat e bukur që do të shënonte skuadra e të rriturve kundër skuadrës kampione), po njoftojmë drejtuesit e fiskulturës, meqë këta mund të kenë qenë të zënë me studimin e plazhit dhe në kërkim të trajnerit të volejbollit, se humbëm shumë thellë.

Në kohën kur basketbollistët e rritura, që kanë fituar admirimin e respektin e thellë të mijëra sportdashësve, brenda e jashtë rrethit, duke fituar në çdo ndeshje, kolegët e tyre, të rriturit, të nisur me një oreks të paparë ndonjëherë në një qytet tjetër, nuk e patën të vështirë të rruftisin 111 pikë nga skuadra vendase. Po kështu edhe futbollistët, duke ruajtur me fanatizëm traditën e krijuar gjatë këtij kampionati, futën me kënaqësi në thesin grykëzgjidhur gjashtë gola, nga të cilët, tre i përkasin javës së shkuar dhe tre javës që jemi. Këto nuk e luajtën skuadrën tonë nga zeroja e madhe.

Atëherë me të drejtë lind pyetja: «duhet të ishin këta shokë në krye të ekipeve? Kësaj pyetjeje iu përgjigj kontrolli i klasës punëtore, që me qarkullimin dhe zëvendësimin e drejtuesve të fizkulturës, duke i çuar afër prodhimit, bëri që sportdashësit të hyjnë, por edhe të dalin të qeshur nga stadiumet e qytetit tonë. . .


MOTËR, Ç'MË KA GJETUR!...

Gëzohem të jesh mirë. Mua nuk më ka prirur shëndeti. Deri para dy muajsh kam qenë e shtruar në ofiçinë, në pavionin e avarive. Shpejtësia, motër, shpejtësia më shpuri atje. Atë ditë që më ndodhi hataja m'u duk vetja sikur fluturoja, ia kalova në shpejtësi edhe veturës së re. Por bereqavers që aty, ndanë rrugës, u ndodh një rul nga ata që shtypin çakëllin dhe më ndaloi hovin që kisha marrë. Besoj se pasojat e këtij lloj frenimi i merr me mend vetë, sidoqë më poshtë do të t'i sqaroj të gjitha.

Tre vjet e ca kemi që nuk jemi parë, që ditën që shkëlëm në portin e Durrësit. Vonë mora vesh se ty të kishin çuar të punoje në veprat e reja që ngrihen andej nga Veriu. Mora vesh, gjithashtu, se kishe lidhur jetën me një shok të mirë. Para disa kohësh të pashë në televizor. Kishit dalë familjarisht (me gjithë rimorkio) Po si nuk kishe ndryshuar fare, moj xhane!?

Të pashë me vëmendje: asnjë rrudhë, asnjë shtrembërim. Të them të drejtën m'u duke ashtu e re si ishe atëherë kur fillove kilometrat e para. Të mban mirë shoku, moj xhane. Dukej ai, se edhe në ekran çelësin dhe leckën nuk i lëshonte nga dora. Po ai spikeri sa lart të ngrinte! Ka kryer një çerek milioni kilometra, tha, dhe derën e «spitalit të përgjithshëm» nuk e ka parë. Të lumtë, thashë.

Pa le kur lexova në gazetë se pesëvjeçarin e ke plotë-



suar brenda tre vjetëve e tani punon për pesëvjeçarin që nuk ka ardhur akoma!

Po mirë këtë, moj motër, po për të ngrënë ha ti apo s'ha, ke stomak ti xhanëm apo s'ke fare? Po nuk më thua, ku i kurseve ato qindra litra naftë? Të ruan ai, moj, të ruan, nuk të le ndezur. Po gomat, moj? Po dhe opingat që janë opinga, apostafat për të shkelur në gurë në gër-xhe, vitin mezi e mbushin, ndërsa ti, që kur ke lindur, vetëm një palë nuk i ke hequr! Po rimorkioja, moj, sa shumë të ngjante! M'u bë shumë qejfi që e mban gjith-një me vete e që e ke futur në punë, se puna të nderon, moj motër. Po nuk punove, e humbet fare. Ta them unë që e humbet dhe e pëson si i ndjeri Xhafer (e humbi si-miten ditën me diell, duke ikur rrugës) dhe të gjen ajo që desh më gjeti mua: për pak dola «në pension» para kohe.

Mua, moj motër, të flas me zemër të hapur, nuk më ka ecur shumë. E jo për fajin tim. Ndërhyri farefisi e miqësia e më lidhën jetën me Malon, që ia kishte përdredhur bishtin njëres. Unë isha e dyta. Do të thuash që ç't'u desh të pranoje një të ve. Ah, moj motër, të thashë, zakon, zakonet prapanike, ato mbeturina mikroborgjeze që bëjnë vend edhe të drejtuesit, më morën në qafë. Nuk ishte ai për patentë, se me 150 mijë kilometra e shpuri në botën tjetër. Bëra si bëra dhe... në fund pranova. I vaj-ti si i vajti me të parën, thashë, me mua... Edhe rimorkion që ka lënë e para, unë do t'ia dua, aq më tepër se është edhe jetime. Jo se të mburrem, po ti e di vetë se sa shumë i dua rimorkiot.

Por ç'e do, u gabova, më trajtoi shumë keq! Jeta m'u bë e vështirë. Ai nuk donte as evlatin e tij, rimorkion, e vaj halli të mirat që do të prisja unë! U katandisa sa nuk më njihnin as shoqet e mia. Punës ia vumë ferrën fare. E fillonim me dy hostenë diell dhe e linim me tre hos-

tenë. Pasi bënim nja tre-katër hostenë pune, më përplaste në park dhe frymën e mbante në bilardo. Pa le kur i shkrepej e më linte në mes të katër rrugëve! Kurrë nuk zuri çelës me dorë. Tre vjet, tre vida nuk më shtrëngoi. U bëra sa që kur ikja rrugës, nga kabina e deri te fundi i karrocërisë, më tundeshin hallatet si këmborët e prishura të Zeqos. Nuk veshi trupi im një gjë të re nga dora e tij. Le atë, po edhe pak prikë që prura në kohën e nusërisë, m'i morën, moj motër m'i morën, m'i rropi ndonjë shok i sërës së tij, kur mbetesh rrugës. Më zhveshën fare, më lanë me minifund. . .

Jam shtruar dy herë në «spitalin e përgjithshëm», kam qenë në rrezik. Një herë s'më pa, një pikë graso nuk më hodhi. Tani, për herë të tretë, isha rëndë fare. «Spitali i përgjithshëm» në ofiçinën qëndrore nuk më pranoi. Hak kishin. Nuk kisha mbushur kilometrat as për një operacion të mesëm e jo për një të përgjithshëm. Të dy herët e para ma qau hallin drejtori e më shtroi. Tani mbeta 15 ditë pa bërë asnjë kurë, e Maloja nuk u duk fare. Ishte mësuar, moj xhane, ishte mësuar të më vinte këmbën e të më shkatërronte, të më thyente nga një balestër në ditë e të më linte pa brinjë fare. «Përgjigjen xhenerikët, — thoshte ai — e ata duhet ta shërojnë». Po komisioni më shtroi në pavionin e avarive. Maloja prapë nuk u duk. Priste t'i thoshnin: «Hajde, se u shërua!» Po aty unë u njoha me një djalë të ri, sapo kishte ardhur në pavionin tonë. Ishe me patentë nafte, po meqë akoma nuk kishte krijuar familje, punonte xhenerik (kishte të pestën edhe si mekanik). I vinte keq për mua që isha katandisur në atë gjendje, në moshë kaq të re. Më shërbente orë për orë. Dhe ra në dashuri me mua. Më bëri propozim dhe unë pranova, por i vura kusht: të mbante rimorkion 7-tonëshë, që më kishte lënë Maloja. Ishte guximtar, moj xhane. Vajti edhe te drejtori.

— E dua unë atë skodën e karamboluar, — tha.

— Po ti je i ri, more djalë, do të gjejmë një të re, se ajo është e vjetër!

— Unë atë dua — tha ai — do ta përtërij.

E kështu kanë kaluar dy muaj që unë lidha jetën me të. Kalojmë aq mirë, sa as vetë nuk e besoj. Kur më pa Maloja me të, u tërbua fare. Më lutej ditë për ditë, po unë nuk ia varja më. U tërbua më keq me procesverbalin që i paraqitën, për dëmtimet që më kishte bërë. Tani po të them me kënaqësi se është i pari muaj, muaj i mjaltit mund të them, që më kanë hequr nga tabela e zezë.

Së shpejti do të takohemi. Kam shprehur dëshirën që të punoj një muaj vullnetare aty, në malësi. Do të ndjek shembullin tënd dhe të shoqeve të tua.

Të fala e përqafile:
Makina me targon 88-33

Ç'NA NDODHI ME NJË LLOGARITAR

I dashur Liçi!

Që të them se jemi bërë për të puthur, këtë s'ma nxë goja, dhe jo për gjë tjetër, po se ti e ke tundur si burrat me taban. Në radhë të parë, o vëlla i mirë, ti nuk ke harruar fshatin tënd dhe meriton nja dy lavdërime të tjera për punën prodhuese. Ja, ke disa vjet që e bën këtu në fshatit tonë, në mes të kooperativistëve. Këto nuk t'i them që të të bëj qejfin, se flasin defterët për ty dhe i gjithë fshati, por ama mos u deh nga lëvdatat, se të vënë në gjumë dhe hajde të gjesh sirenë të zgjohesh pastaj! Mos më merr për profesor për këto këshilla që po të jap, por e kam për detyrë të t'i them, se jam nja dy vjet më i madh se ti, të kam tundur, or byrazer, të kam tundur në djep, se djepe kishim ne atëherë.

T'i lëmë shakatë e të futemi drejt e në temë. Në këtë letër po të shkruaj për një çështje të rëndësishme: Ne, or mik, na ka ardhur një listë, po sa thua ti? — sa një çarçaf? E ç'ka në të? Emrat e disa nëpunësve që do të kryejnë punën prodhuese këtu në kooperativën tonë. Këta duhej ta bënë punën prodhuese që në fillim të janarit. Sa të mbaronin gjelin e detit, të nesërmen ne i prisnim në arë, por, siç e shikon, tani jemi në të dalë të shkurtit dhe as gjysmat e tyre nuk janë dukur në kooperativë. Disa nga ata që kanë ardhur janë seriozë në punë, punojnë tok

me brigadën dhe normën e realizojnë. Ti e di që ne tani jemi në aksionin e hapjes së tokave të reja dhe, po ta them troç, nuk jemi keq, puna na ecën mirë. Po hë pastaj, hajde llafosu me ata që nuk marrin shembull nga shokët dhe shoqet e tyre! Nuk është puna se do të vijnë ata e do të na nxjerrin nga viti, jo, or jo! Vitin e kemi siguruar me kohë ne, po për të mirën e tyre, a derëbardhë, për të mirën e tyre, të mësojnë, ore, të mësojnë, se jeta shkollë është.

E beson se ca janë analfabetë në këto punët e bujqësisë? Është shkencë bujqësia, ore Liçi; të shohin si prodhohet buka, ja, për këtë ta kam.

E di ç'na ndodhi vjet? Na erdhi një llogaritar nga një ndërmarrje e qytetit. Ishte llogaritar i parë apo i dytë, këtë nuk ta them dot me siguri, por që ishte llogaritar kjo dukej sheshit, që nga pyetja e parë që më bëri:

— Hë more, me bilancin si jeni?

— Mirë, i thamë ne, — se mirë ishim vërtet. Ne e dinim që do të vinin nja tre-katër vetë për punë prodhuese, ndaj ua kishim përgatitur gati shatat për të prashitur misrin.

— Po këto vegla pune si i lini kështu? — i keni në inventar, apo s'i keni? Pse nuk i futni në magazinë? — na dha një breshëri pyetjesh llogaritari.

Por xha Zeqoja, ai pensionisti, që erdhi para 10 vjetësh nga kryeqyteti për të jetuar në fshat me gjithë fëmijët, ia preu aty për aty:

— Nuk janë për magazi ato, jo, janë për punë, s'kanë nge për gjumë! Por, pa më thua, a të hanë gjë duart?

— Jo, nuk më hanë duart, — ia ktheu llogaritari, dje e morëm rrogën.

— Për punë, për punë, po të them, se edhe unë e mora timen! Se, që ta marrësh vesh ti, or mik, po s'të hëngri dora për punë, nuk të ha as për rrogë!

Këto tha xha Zeqoja, e vrapin e mbajti në brigadë. Pastaj ai llogaritari u drejtua nga unë:

— Shoku përgjegjës, — më tha, — për llogari më vjen shumë ndoresh, ç'të duash ta jap me senet brenda orës, jam llogaritar i vjetër, kam edhe eksperiencën edhe shkollën.

Ç't'i thoshja? Edhe mua s'm'u durua:

— Ç'na kujton ti, se jemi në vitin e parë të krijimit të kooperativës? Dëgjo këtu: shefin e llogarisë e kemi djalin tonë, nga fshati e kemi, me universitet; edhe të planit po ashtu, kryetaren e kemi agronome; ato çupat që drejtojnë brigadat i kemi agronome të mesme. E di ti që edhe anëtarët e brigadave vazhdojnë shkollën pa shkëputje nga puna për agronom, ndërsa ca e kanë mbaruar? Kurse unë me nja dy shokë të tjerë vazhdojmë filialen!

Ke parë ti, Liçi, që ai hapte sytë; të mos merrte vesh tjetri se ç'bëhej në fshat?! Po edhe hak kishte, asnjëherë nuk kishte ndenjur në fshat më tepër se një natë. Po kiameti më i madh qe kur i mblodha për të ndarë punën.

— Ty, shok, — i thashë llogaritarit, — të kemi caktuar në maternitetin e laramaneve dhe të holandezeve, ju të tjerët në prashitje. Kur dëgjoi këtë, llogaritari më shikoi me inat dhe u xhindos fare.

— Me kë tallesh, — më tha — me mua, që kam ardhur nga qyteti për ndihmë? — Dhe brofi në këmbë. — Ta rregulloj unë te kryetarja!

Dhe sakaq iku tërë inat. Aty për aty nuk e kuptuam se ç'pati, vetëm pamë që ikte drejt kryesisë. Kur doli në anë të rrugës, ku ishte një «veshgjatë» duke kullotur bar, për t'u ruajtur nga ndonjë vickël e tij e dëgjuam kur i tha një çuni që kujdesej për të:

— Ore djalë, ore djalë, hiqe atë mushkën andej, sa të kaloj. Se të qëllojnë ato dreqka! Një nga këto ma ka bërë çyryk gjyshin, pastaj bëjnë edhe zarare këto!

Ca fshatarë, që e dëgjuan, u shkrinë së qeshuri. Ai ktheu kokën dhe u ardallos më keq. Kur arriti në zyrën e kryetares, ishte bërë tym fare. Kryetarja e uli në karrike dhe, pasi e qetësoi, më thirri edhe mua.

— Ç'ka shoku? — më tha.

— Nuk e di, — i thashë. — Unë e caktova në maternitet, kurse shoku u inatos.

Llogaritari shikonte i habitur.

— Le të vejë në bokset e viçave atëherë.

Llogaritari i hodhi sytë nga kryetarja: «Ç'dreqin bëhet këtu, xhanëm!» sikur thoshnin sytë e llogaritarit.

— Moj shoqja kryetare, ç'janë këto bokset? S'po ju marr vesh!

— Janë çerdhet e viçave, — i tha kryetarja — materniteti është vendi ku pjellin lopët.

— Ashtu më thoni, or vëllezër, se e mora jangllësh! Me sa shoh unë, do të qeshni akoma me mua ju, se e kam parë me dylbi fshatin unë!

Llogaritarin dhe shokët e tjerë ditën e parë i shëtita dhe ua spjegova të gjitha. Kur shkuam te materniteti i lopëve, pa hyrë brenda, doli Drita me bluzë të bardhë.

— I thuaj një çikë infermieres të më mjekojë pak gishtin se e kam prerë me brisk, kur bëja majën e lapsit «2001 HB», — më tha llogaritari kur pa Dritën.

E mbajta të qeshurën me zor, «Edhe markat e lapsave mbaka mend! — thashë me vete — Qenka i prerë për llogaritar!»

— Nuk është infermiere, — i thashë. — Ajo ushqen lopët, po edhe tek infermierja do të shkojmë. Atje kemi edhe doktorin.

Megjithatë gishtin e mjekoi. Pak lëkurën kishte hequr.

Gjithë muajin punoi te viçat. Atë ditë që iku më përqafoi dhe nuk më lëshonte.

— Ma ke bërë borxh, — më tha. — Këtu mësova aq shumë sa që dola në një botë tjetër.

E di, ore Liçi? Këtë vit ai llogaritari ishte i pari që e nisi djalin e tij për të punuar këtu në fshat. «Të vesh atje, — i kishte thënë djalit. — Apo do që të mbetesh fyell si unë?»

Tani të kthehemi prapë tek ata nëpunësit që nuk kanë ardhur akoma. Bëju një kritikë në gazetë, të vijnë këtu në fshat, se kanë ç'të mësojnë. Le të vijnë sipas planit, se edhe ne kemi planet tona këtu. Ndërsa ty të pres të vish sa më parë, punën ta kemi caktuar atje ku punëve vjet.

VRAPIM PËR SKEÇE

Përgjegjësi i vatrës së kulturës, si zbriti nga urbani, bëri një vizitë në kafe-pijetoren e kooperativës dhe, mbase lagu fytin me një fërnëtë esëll, bëri një rrotullim të plotë rreth vetes dhe hodhi vështrimin përfaqë të territorit se mos e pa ndonjë «sy i lig». Pasi u sigurua mirë për këtë e mbajti vrapin prapë tek urbani. E hante shumë qytetin qerratai, paçka se kishte lindur në fshat. Fshatit ja harroi emrin sapo vuri këmbën në qytet për të parën herë.

Ky, Meleqi, kishte gjashtë muaj që firmoste borderonë për punë kulturore këtyre anëve. Sa herë që vinte nga qyteti për në fshat, (se kur i hipte në kokë nuk vinte fare) nxinte i tëri, ama kur kthehej sërish në qytet i qeshte nuri. Kënaqeshin udhëtarët me të, kur ai vinte në qytet, kënaqeshin ata me zërin e tij, me këngët e tij. Ja edhe këta ai bënte gabim që nuk i regjistronte në aktivitetet e vatrës së kulturës, se shfaqje ishin, nuk ishin gorrica. Ndoshte që ndonjë kooperativist të pyeste Meleqin:

— Nga ke qënë, o Meleq, s'të kemi parë fare?

Ai përgjigjej:

— Për skeçe, për skeçe. Kërkova nja dy skeçe. Është punë e madhe të kërkosh skeçe, — vazhdonte ai. — Ore, arën e punon dhe e prashit se ka edhe mekanizma, — vazhdonte Meleqi, — por skeçit s'ke ç'i bën, do damar

ai i flamosur, se ku është ai damar, në zverk a në ballë, këtë hajde gjeje, po që do damar kjo punë, këtë e them me kompetencë, se kam lexuar një libër që aty shpejti, për çështje të tilla — thoshte Maliqi.

Mirëpo një ditë, në aktivin e rinisë të kooperativës, ku kishin futur edhe kryetarin, edhe Maliqin, të cilit nuk i gjendej adresa, të rrinjtë e ngritën zërin:

— Ku janë grupet artistike?

Në atë mbledhje kryetari bëri një autokritikë të fortë lidhur me grupet artistike që s'i kishte parë krahas punëve në prodhim.

— Djema! — tha kryetari. Nesër të mbledhim diletantët, të lajmërohet edhe ai firauni, Meleqi, e të fillohet nga puna.

— Se kemi edhe festivalin për dy javë, — tha një vajzë.

— Kemi, s'kemi festival, ne grupet duhet t'i mbajmë ngritur, — tha një djalosh tjetër.

Të nesërmen në vatrën e kulturës u mbledhën amatorët. Për çudi aty ishte edhe Meleqi.

— Të fillosh nga puna me grupin menjëherë! — i tha kryetari Meleqit.


— Duhet skeçe — ia ktheu përgjegjësi i vatrës së kulturës.

— T'i gjesh menjëherë dhe të fillosh nga puna, — përsëriti kryetari.

Meleqi u nis në qytet shpejt e shpejt. Kaluan një, dy, tri ditë. Diletantët prisnin përgjegjësin. Përgjegjësi priste të gjente skeçe në qytet...

— Ai s'po duket. Si mendoni, shokë, të fillojmë vetë? — u tha sekretari i rinisë.

— T'i bëjmë një telegram me përgjigje, — tha një kooperativiste, e cila do të luante rolin kryesor në një skeç të bukur që kishte krijuar një i ri. Mendimin e saj e



aprovuan të gjithë. Një djalosh shkoi në postë dhe bëri një telegram në adresë të Meleqit. Të nesërmen erdhi përgjigja e telegramit: «Meleqi kërkon skeçe. Hëna».

I riu që mori telegramin me të shpejtë shkoi në vatrën e kulturës. Aty ishin mbledhur të rinj e të reja. Kur morën vesh përgjigjen e telegramit ata qeshën. E pse të mos qeshnin! Ç'dreqin kërkonte Meleqi në hënë?! Hajde prit Meleqin tani, pa le në ja shtrofshin me dreka e darka andej nga hëna. Dhe akoma më keq në iu mbushtë mendja të shkojë në Mars apo në ndonjë planet tjetër, prandaj s'është gjë kjo punë. «Hajt të fillojmë nga puna», — thanë amatorët.

— Të fillojmë, të fillojmë pa tjetër! S'kemi ç'presim Meleqin nga hëna, — tha një arsimtar, që do merrte pjesë në grupin e estradës. — Në buletinin «Estrada» ka skeçe shumë të mirë. Edhe materialin tjetër që na duhet ne mund ta bëjmë me forcat tona, — vazhdoi ai. — Hakuu që punon në sektorin e dytë ka shkuar vazhdimisht. Agronomi dhe disa nga ne arsimtarët kemi forca për ta shkruar.

— Po, po, t'i shkruajmë vetë skeçet, — tha kryetari. — Hajdeni djema! Edhe unë do të provoj të shkruaj një pjesë. Të kritikojmë të metat e punës që kemi.

— Të bëjmë edhe një skeç për Meleqin, — propozoi një vajzë.

— Ta bëjmë, — thanë të gjithë.

Atë ditë filluan nga puna. Skeçet u përgatitën për bukur. Orkestrina me këngëtarët bënë punën e tyre. Brenda dy javëve numri i estradës u bë gati. Të dielën e javës së fundit grupi dha një shfaqje të këndshme për kooperativistët dhe të nesërmen u nis në qytet për në festival. Në drekën e asaj dite në fshat u duk Meleqi. Si pa që tek vatra e kulturës nuk pipëtinte as miza, u nis me ecje sportive drejt kryesisë. Në derë u duk kryetari. Meleqi

u mat ta puthte, por kryetari hoqi kokën mënjanë, kështu që tjetrit i shkoi huq e puthura.

— Po ku humbe si sopata pa bisht? — i tha kryetari.

— U vonova vërtet, por bëra një punë të madhe. Kam gjetur tri skeçe dhe një kuplet.

— Ke gjetur kuletë?! Ma jep mua se është e imja, — i tha një fshatar që kishte humbur qesenë e duhanit.

— Jo, jo, ç'kuletë thua ti! kuplet po të them, kuplet me shakara.

— Aha, s'e di unë atë, unë kam hallin tim, — tha fshatari dhe iku.

— Eja të shkojmë tek autobuzi, se po niset, — i tha kryetari Meleqi.

— Pse do vini edhe ju në qytet? — pyeti Meleqi.

— Po, do të vij, të argëtohem me ndonjë shfaqje andej.

— Ashtu! — u gëzua Meleqi. — Po më kënaq, shoku kryetar. Qenke i apasionuar pas artit, si puna ime.

— Shumë! — i tha kryetari.

— Edhe unë shumë fare, vazhdoi tjetri.

Hipën në autobus. Në orën 18 pa 10 minuta zbritën pranë kinoteatrit. Hynë në sallë. Meleqi u habit kur pa që në kohën që po ngjithnin shkallët për të gjetur vendin, kryetarin e përshëndesnin me kokë shumë nga spektatorët që ishin në sallë.

— Qenke i njohur edhe në qytet, — i bëri Meleqi një kompliment kryetarit.

— Si puna jote — i tha kryetari, që s'e hëngri thatë. «Hajde ç'kali pa fara është, mendoj me vete. Nuk njeh as bashkëfshatarët që kanë ardhur për të parë estradën e kooperativës. Mos thuaj pastaj që as fshati s'e ka parë këtë dhe as ky s'e ka parë fshatin».

Pasi zunë vend me numrat e biletave. Nën tingujt e orkestrinës popullore filloi të hapet perdja. Kooperativis-

tët dolën në skenë duke kënduar. Meleqi hapi sytë. Në skenë po shikonte ca fytyra të njohura, ishin disa nga ata që i hanin veshët përditë për të ngritur grupin e estradës. Kooperativistët po interpretonin me sukses skeçet dhe këngët. Meleqit filluan t'i bien djersët. Ktheu një herë kokën të shikonte nga kryetari që ishte përqëndruar në skenë, pastaj nga shoferi i kooperativës që e kishte në kra-hun tjetër. Shoferi filloi t'i bëjë fresko se mos i binte të fikët në mes të sallës. Kur arriti programi te skeçi që bënte fjalë për Meleqin nuk mbajti më ujë pilafi. Ajroset filluan t'i ftoheshin. Meleqi u bë gati të ngrihej.

— Qëndro, — i tha kryetari. — Shikoje deri në fund. Të bëjnë mirë djersët, të djersish të paktën këtu, me që për punën që të është ngarkuar nuk ke derdhur asnjë pikë. Dhe mos u çudit se do të djersish prapë në mbledhje, atje në mes të kooperativistëve. Bile jo vetëm aty. Djersa më e madhe të pret në fushë.

Dhe vërtet djersiu dhe djersiu aq shumë sa që në atë mbledhje Meleqi ra tri kile nga pesha dhe vazhdon të djersijë edhe sot e kësaj dite kur prashit misrin, pambukun e kur mbledh spinaq. Në vatrën e kulturës tani për tani është vetëm aktor, ka filluar të shkruajë edhe një skeç.

CJAPI PA KOKË

Kisha rreth një javë që nuk më ishte bërë mbarë të delja nga shtëpia e Cacit, ca nga punët, ca nga mukajeti, se gjë e madhe është edhe mukajeti, në fshatin tonë. Tregojnë se edhe Peçi nga mukajeti mbeti pa nuse! Megjithatë të enjten e fundit të muajit që shkoi, si lashë punën, u ktheva në sportelin e teatrit të qytetit dhe preva disa bileta për premierën e fundit. Këtë herë do të merrnim edhe gratë e kalamajtë. Pasi preva biletat mora rrugën për në shtëpi. Kur u afrova tek pallati ku banon Caci, nga që isha pak i lodhur, vendosa të thërras që poshtë.

Dola nga ana e prasme e pallatit, se t'ju them të drejtën, më vinte turp të thërrisja nga rruga kryesore. Mendoj se është mungesë kulture t'i thërrasësh tjetrit si në pyll. Megjithatë ishte si ishte, unë ia veshja atë ditë. Mbasi mblodha fuqinë dhe si e vura totalisht në dispozicion të mushkërive e gurmazit, thirra me sa kisha në kokë. «O Caci! Caci!» Pasi thirra edhe nja dy herë të tjera, ç'të shoh? Në ballkonin që kombinonte me banjon nxori kokën një cjav larash me dy brirë të mprehur lart. «Hej, drej o punë», thashë me vete. «Unë i thërras Cacit dhe më del cjapi! Por ç'dreqin kërkon cjapi aty në ballkonin e Cacit?»


Ndërkohë cjapi më nguli mirë sytë, lëpiu një herë buzët rreth e rrotull dhe pa më thënë asnjë llaf, u hodh një

herë përpjetë, mori vrull dhe ia dha pastaj me një kërcim akrobatik nga kati i pestë në këmbët e mia. Sikur të mos kisha bërë një kërcim së gjati, do më kishte zënë nën vete dhe do të isha bërë kurban, në rrëzë të pallatit së bashku me të.

Ç't'u them! E humba fare. Jam bërë 30 vjeç burrë dhe deri më sot kisha dëgjuar që në lagjen tonë, tek-tuk, kanë mbajtur gjela deti brënda në pallat, që i ushqenin me tule bukëgruri e misri, për t'i majmur për vitin e ri. Kisha dëgjuar edhe për tëmën e Zeqos, që kishte hipur në majë të thanës, por që të hipte cjapi në pallat dhe në katin e pestë, këtë nuk e kisha dëgjuar ndonjë herë dhe nuk do ta besoja po të mos e kisha parë vetë me sy. Po paskam qenë vulhumbur fare! Si nuk më kishte vajtur mendja xhanëm kur shikoja Gëzimin, të birin e Cacit, që kur kthehej nga furri i bukës kohët e fundit nuk merrte më një bukë, por një bukë e gjysmë! Dhe unë kujtoja se Cacit do t'i qe shtuar oreksi. «Shyqyr! — thosha me vete, se u bë për të mbushur xhepat me gurë kur fryn erë e nuk la hudhra në këmbë tek pazari i fshatarëve!» Ai, Caci, kishte edhe një palo tabjat: Donte hudhra të porsashkulura, pa hudhra ka edhe në njësitë e zarzavateve sa të duash në daç të njoma e në daç të thata.

Le të kthehemi prap tek cjapi, që mbeti dëng pa markë para meje. Kur ra përtokë, një bri iu thye, ndërsa këmbën e pasme, atë të majtën, e tundte nga pak. U mblodhën plot njerëz. Kishin hak. Që të binte ndonjë vazo me lule nga ballkoni i ndonjë qytetari, kishte bërë vaki, por që të binte një cja, as e kishin parë e as e kishin dëgjuar. Një plakë që e kisha në krah, duke më marrë për të zotin e cja-pit, m'u afrua dhe më tha me keqardhje:

— Të rrosh vetë, shyqyr që ishte me kaq, pa ky do ta thyente zverkun një ditë. Nuk e shikon si e tundi këmbën e mëngjër?



— Faleminderit! — thashë unë duke pritur ngushëllimin e duke kujtuar edhe një herë skenën tragjike kur më ra cjapi gati në kokë.

U mata t'i bëja ca lëvizje cjamin, nga ato lëvizjet gjimnastikore, mirëpo kur pashë që ca nga të pranishmit në aksidentin e cjamin, ja shkrepën të qeshurit, hoqa dorë nga ky mendim. Dikush nxori nga brezi një derro biçak që ja hodhi kokën matanë cjamin aty për aty. «E shpëtuam» më tha, duke fshirë duart në lëkurën e cjamin. Po atë çast vumë re se Caci po fërkonte sytë nga ballkoni i katit të pestë dhe ashtu me pizhama, duke i kapërcyer shkallët nga katër e nga pesë (siç tregojnë ata që e panë) e mbajti frymën tek ne. Nji pikë loti i rridhte nga syri i dhathtë.

— Ti i thire cjamin? — iu drejtua një komshiu që sapo kishte ardhur.

— Jo, — ia ktheu tjetri.

— More lëri ato ti, mos m'i shit mua. Unë të dëgjova, po m'u duk sikur isha në ëndërr, — ja priti prap Caci me nervozizëm.

— Do kesh qënë në ëndërr. Unë nuk i thirra. Pastaj ç'më duhej mua me cjamin. Unë personalisht nuk njihesha me të!

— Të më paguash cjamin, — vazhdoi Caci të grindej me komshiu.

— Turp, turp! Goxha burrë me thinja, u more me një cjamin axhami, me një karçin, — i tha një djalosh komshiut duke i shkelur syrin për të qesëndisur Cacin.

— Jo, or Caci! jo! Pse bëhesh qesharak! — i thashë. — Unë thirra, por jo cjamin, por Cacin. Me sa duket cjamin e mori jangllësh, nuk e dëgjoi mirë...

Ndërkohë vjen një burrë me bllok në dorë.

— Kush është i zoti i cjamin? — pyeti ai.

— Ja ky shoku, — u hodh një plakë, duke treguar Cacin me gisht.

— T'u ketë lënë shëndenë, s'ke ç'i bën! Kështu e ka kjo jallane, — tha burri me bllok.

Caci shikonte me habi. Burri i moshuar shfletoi bllokun i vuri një fletë karboni, nxori dhe lapsin kopjativ dhe iu drejtua Cacist:

— Firmose pak!

Caci çpalosi sytë.

— Përse ta firmosë? — i thashë unë. — I takon 300 lekëshi i vakisë, kështu?

— Jo! — I takon gjoba, se ka mbajtur cjapin në pallat dhe më e keqja është se e ka ushqyer me bukë! — ma ktheu burri me bllok.

Caci nguronte të firmoste.

— Firmose, Caci! — i thashë unë. — Firmose jo vetëm për gjobën, por edhe që të bëhesh luftëtar kundër atyre që mbajnë qëngja e gjela deti në apartamente, kundër atyre që shpërdorjnë bukën.

Caci firmosi me sy të drejtuar nga cjapi pa kokë. Ne të gjithë u shpërndamë. Pastaj ai shkoi në furrë, mori bukën, por jo më një bukë e gjysmë po një, pasi cjapin e hoqi nga defteri i shtëpisë.

— Kur të kesh oreks, hajde të marrësh edhe dy, — i tha shitësja e bukës. Sigurisht kur të kenë oreks njerëzit dhe jo cjepët dhe gjelat e detit.

Unë dhashë e mora që si e si ta mirrja me të mirë e ta lehtësoja shokun tim. Atë natë shkuam edhe në teatër, megjithëse cjadi s'i kishte mbushur të shtatat.

P Ë R M B A J T J A

1. Lefkoja u kthye në fshat	3
2. Xhevahiret e Bahirit	9
3. Sadiku ngatërroi derën... ..	11
4. Këto askush s'i honeps	16
5. Në rrugë... ..	19
6. Taktika e Zeqos... ..	24
7. Ku i shpie mushka?	30
8. Sadushit i shtrënguan burgjitë	32
9. Lirikën e hodhën në fshat	36
10. O dentiste, o farmaciste!	40
11. Zemra e tij ishte dëmtuar nga rehatia	43
12. Dollapi i Veqos dhe i Zeqos... ..	47
13. Kur meraku i dimrit të zë në behar	50
14. Të drejton e të tregon vendin gruaja	54
15. Kanë «halle» drejtuesit e sportit	58
16. Motër, ç'më ka gjetur!... ..	61
17. Ç'na ndodhi me një llogaritar	66
18. Vrapim për skeçe	70
19. Cjapi pa kokë	77